



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 DHE 12 MARS 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 5. I 12. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Debat parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara

## **Dnevni red**

1. Parlamentarna debata o odluci Vlade Republike Kosovo za izdavanje finansijskih sredstava iz nepredvidenih troškova

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 44 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa deputetë janë në sallë? Janë 20 deputetë të pranishëm, ndërsa 44 kanë kërkuar seancë, e vetëm 20 vijnë.

Procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

### **1. Debat parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara**

Të nderuar deputetë,

44 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.

E ftoj Driton Selmanajn, që në emër të propozuesit, ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

DIRTON SELMANAJ: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Meqenëse është një numër jashtëzakonisht i vogël i deputetëve sot të pranishëm këtu dhe arsyeja sipas tyre është që janë pjesë e një manifestimi që po ndodh për Epopenë e UÇK-së, ne mendojmë që pikërisht nderi më i madh dhe nderimi më i madh për të gjithë ata që kanë rënë për këtë vend do të ishte nëse ne do ta diskutonim shpenzimin e parasë publike pikërisht për ngjarje të tilla, sepse bindja jonë e thellë është që në këto ngjarje po keqpërdoren dhe po manipulohen shumë para të Buxhetit të shtetit të Kosovës.

Nëse dikur është thënë dhe është vërtetuar që këta njerëz vjedhin me varrezat e dëshmorëve dhe me lapidarët e tyre, tash kanë filluar të vjedhin edhe në letrat e tualetit dhe në pakot higjienike.

Prandaj, meqenëse ka një numër kaq të vogël të deputetëve, ne kërkojmë që kjo seancë e jashtëzakonshme të shtyhet për datën 12 mars, në orën 10:00. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Propozuesi ka kërkuar vetë që të shtyhet seanca. Atëherë, në këto rrethana nuk di pse të vazhdojmë. Milaim, urdhëro!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë kam ardhur në seancë vetëm për ta shprehur protestën time publike dhe zhgënjimin tim të madh ndaj propozuesve të kësaj seance, sepse nuk thirret seancë e jashtëzakonshme ditën e shenjtë të Prekazit dhe të Epopesë të Lavdishme.

Dhe, mënyrë për të arsyetuar dhe për ta justifikuar këtë gabim kaq trashanik është tërësisht e pavend.

Sot është ditë e martë, dhe ditën e martë është edhe njëfarë lloj dite e zezë, plus ne e dimë që çdo vit mbahet Epopeja më 5, 6 dhe me 7 mars. Kemi një milion probleme për të cilat Parlamenti i Kosovës ka mundur të thërrasë seanca të jashtëzakonshme e të diskutojë dhe jam në mënyrë absolute pro thirrjes së seancave për keqpërdorimin e parave publike, por ne sot e kemi një ditë të shenjtë.

Prandaj, unë personalisht jam shumë i zhgënjyer dhe shumë i shokuar pse e keni thirr këtë seancë dhe pse është caktua mbajtja e saj. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Të mos hapim debat, edhe ashtu nuk e ka kërkuar askush fjalën. Nënkryetari Kujtim, a ka mundësi vetëm për një konsultim para se të dal në përfundim.

Atëherë, me kërkesën e propozuesit të seancës, kjo seancë ndërpritet për sot, pastaj pas mbledhjes së Kryesisë e përcaktojmë edhe mënyrën e vazhimit të këtij debati.

Fola me nënkryetarin, për atë arsye thashë, është çështje e propozuesit, se Kryesia ka marrë vendim, kjo ishte edhe arsyeja e konsultimit që e bëra me nënkryetarin. Është çështje e propozuesve, unë s'kam të drejtë, e di kërkesën tuaj, prandaj kjo ishte arsyeja pse e thirra nënkryetarin. Ju njoftoj me kohë.

Në qoftë se insiston, më duhet të ju thërras prapë në orën 10:00, s'kam çka të bëj. Faleminderit! Mirupafshim në seancën e radhës!

\* \* \*

*E martë, më 12 mars 2019*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 5 mars 2019*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju lus që t'i zini vendet.

Koha është të fillojmë debatin, siç është kërkuar, dhe po e fillojmë.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

44 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.

Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën për të parashtruar çështjen e debatit.

DRITON SELMANAJ: Përshëndetje të nderuar ju pak kolegë deputetë,

Në fakt, sot nuk po e kuptoj pse partitë politike në pushtet nuk janë këtu, nuk e di nëse ka ndonjë ngjarje tjetër të një rëndësie që këta e vlerësojnë, po gjithsesi kur po flasim për abuzimin e parasë publike në Kosovë, kam përshtypjen që ky pushtet s'ka interes as të dëgjojë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Me iniciativën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje dhe të përkrahur nga dy deputetë të pavarur, Mimoza Kusari Lila dhe Ilir Deda, kemi thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme për të debatuar lidhur me vendimet e Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara, apo që ndryshe njihen si “Rezerva shtetërore”.

Ne e kemi thirrur këtë seancë të jashtëzakonshme për shkak se nuk kemi arritur që për këto çështje të marrim përgjigje nga Qeveria përmes instrumenteve të tjerë të mbikëqyrjes parlamentare.

Ne kemi ftuar për raportim në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike kryeministrin e vendit, por ai nuk ka ardhur, ai ka zgjedhur që ta dërgojë këshilltarin e tij personal, po normalisht me nivele të tilla ne nuk diskutojmë.

Të nderuar deputetë,

Qeveria aktuale e Republikës së Kosovës që nga marrja e mandatit ka filluar zbatimin e një praktike sa të keqe, po aq edhe të papranueshme të ndarjeve buxhetore përmes vendimeve të Qeverisë, me theks të veçantë ndarjen e mjeteve financiare nga vija buxhetore “Shpenzimet e paparashikuara”.

Ndarja dhe destinimi i këtyre mjeteve po bëhet pa një planifikim të qartë, pa kritere vlerësuese, pa analiza financiare buxhetore, pa analiza të nevojave, thënë më shkurt, këto vendime kanë vetëm një qëllim: të plotësojnë apetitet elektorale të kryeministrit dhe koalicionit PAN.

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përmes nenit 29, ka përcaktuar qartë procedurën dhe rastet se kur mund të merret vendimi për shfrytëzimin e rezervave shtetërore.

Shpenzimet e paparashikuara apo rezervat shtetërore mund të shpenzohen vetëm në raste urgjente dhe të paparashikuara.

Organizatat buxhetore mund të aplikojnë në ministri për fonde shtesë, por që në aplikacion duhet të shpjegohen arsyet se këto fonde nuk kanë mundur të parashikohen më herët.

Shmangia e respektimit të dispozitave të tilla shpreh logjikën abuzuese të shpenzimit të parasë publike në Kosovë.

Vetëm për pjesën e fundvitit 2017 dhe 2018 Qeveria e Kosovës ka nxjerrë mbi 60 vendime të veçanta, që kapin shumën prej 8 milionë e 387 mijë e 282 euro nga linja buxhetore Shpenzime të paparashikuara.

E njëjta praktikë po ndodh edhe gjatë këtij viti, ku vetëm për dy muaj, janar-shkurt 2019, me vendimet e Qeverisë janë ndarë mbi një milion e 700 mijë euro, përfshirë këtu edhe vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500 mijë euro për realizimin e aktiviteteve të shënimit të 11-vjetorit të pavarësisë. Pra, vetëm për dy muaj afër 50% e fondeve të cilat kanë qenë të alokuara për rezerva shtetërore kjo Qeveri i ka shpenzuar.

Meqë jemi te kjo ngjarje, pra shënimi i 11-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës më datën 12 shkurt 2019 ka nxjerrë vendim që nga fondet rezervë të ndahen hiç më pak se 500 mijë euro për realizimin e aktiviteteve për këtë ngjarje.

Edhe pse Qeveria, besoj që e ka ditur datën dhe rëndësinë e kësaj feste, ajo këtë ngjarje nuk ka mundur ta planifikojë më herët, madje as ta parashikojë në buxhetin për vitin 2019, edhe pse Ligji për buxhetin ishte miratuar nga Parlamenti vetëm 9 ditë para këtij vendimi.

Jo vetëm forma e marrjes së këtij vendimi, e pakuptimtë mbetet edhe shuma kaq e madhe për këtë ngjarje.

Krahasuar me vitin 2016 dhe 2017, ku për këtë qëllim ndaheshin shuma në vlerë 70 mijë euro, Qeveria aktuale thuhet se me aktivitete të njëjta, për aktivitete të njëjta me ato të dy vjetëve të mëhershme ndan shtatëfish më shumë, pra 500 mijë euro.

Meqë aktivitetet ishin pothuajse të ngjashme, atëherë Qeveria u kujdes që ta përzgjedhë një kompani, e cila nuk do të kujdesej vetëm për aktivitetet, por edhe për fryrjen e çmimeve, faturave, sepse shifra prej 500 mijë eurosh së paku në letër do të duhej të arrijë me domosdoshmëri.

Disa shembuj që e faktojnë këtë: kompania “Dizarium”, e përzgjedhur për këtë punë, vendos që në ofertën e negociuar me Qeverinë çmimin për Federatën e Aeronautikës ta faturojë hiç më pak se 12 mijë e 520 euro, kurse Federatën e kontraktonte me vetëm 800 euro. Këtu e kam edhe kontratën, në të cilën shënohet shifra 800 euro.

Në reagimin publik të kësaj federate dhe nga kontakti që kam pasur me ta, ata thonë se parashutat që u shfrytëzuan për këtë ngjarje janë blerë me para të tyre, disa vjet më parë, kurse në ofertën e miratuar nga Qeveria për këtë qëllim thuhet se janë paguar 5 mijë e 770 euro.

Për t’u mos u mjaftuar me kaq, kjo kompani për këtë emblemë, të nderuar kolegë deputetë, ka paguar 4 euro e 90 centë, afër 5 euro dhe unë kam kontaktuar tri kompani që i shtypin këto, çmimi maksimal për një copë është një euro.

Po e marr shembullin tjetër, për një laps kimik është paguar ose është ofertuar nga kompania “Dizarium” çmimi tri euro.

Po ju them, të nderuar kolegë deputetë, që për 10 ditë nuk ka ministri dhe zyrë të kryeministrit që unë nuk kam kontaktuar për ta sigurua një laps kimik të vetëm, asnjë s’kam mundur ta siguroj. Dhe shtrohet pyetja, në fakt, a janë bërë këta lapsa, a janë përgatitur këta lapsa dhe kur kam kontaktuar me shumë prej kompanive që merren me këto çështje, thonë çmimi në treg sillet rreth 30 deri 50 centë, ne kemi paguar 3 euro dhe nuk e di, prapë po them, a janë shtypur apo jo.

Dhe, në fakt, kam përshtypje që kjo nxjerr një logjikë, dhe cila është kjo: që kjo qeveri lapsit ia ka ndërruar funksionin, në vend që të shkruhet me laps, këta mendojnë që duhet vjedhur me laps.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Për gjithë këto dallime në çmime dikush ka mashtruar, ose kompania, ose Qeveria, ose të dyja bashkë. Për këtë organet e drejtësisë do të duhej të nxjerrin të vërtetën e saktë.

Po për të njëjtën datë dhe ngjarje, vitin e kaluar Qeveria e Kosovës me vendim kishte ndarë fillimisht 600 mijë euro nga fondet rezervë, për të mos marrë vëmendjen e publikut, ajo u kujdes që kësaj shume më 11 shtator 2018 t’ia shtojë edhe 255 mijë e 613 euro të tjera. Pra, në total, kjo festë u kushtoi taksapaguesve të varfër kosovarë vitin e kaluar 855 mijë euro.

Edhe për ngjarje Qeveria e tregoi se 10-vjetori i shpalljes së pavarësisë së Kosovës ka dalë i rastësishëm, sepse askush s'ka arritur ta planifikojë më herët.

Por nga fondi rezervë vitin e kaluar kjo Qeveri morri vendim për ndarjen e 500 mijë eurove për shënimin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeu, sigurisht edhe kjo ngjarje për Qeverinë ishte e rastësishme dhe e paplanifikuar.

I rastësishëm dhe i paplanifikuar doli Vendimi edhe i Qeverisë i datës 12 shkurt 2019, për ta mbështetur me 180 mijë euro projektin filmik “Lojë jete” të produksionit “Iliria Film”.

Të nderuar deputetë,

Rastësinë e këtij vendimi duhet kuptuar sepse ky projekt ishte refuzuar për t'u mbështetur vitin e kaluar nga juria profesionale e Qendrën Kinematografike të Kosovës. Jam shumë i bindur dhe e di që edhe ju e ndani këtë mendim që juri më profesionale për të vlerësuar vlerat artistike të një filmi është Qeveria e Kosovës se sa Qendra Kinematografike e Kosovës.

Nga rezerva shtetërore Qeveria e Kosovës ka vendosur të paguajë edhe Komisionin Shtetëror për shënime dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror.

Sipas kërkesës së këtij komisioni, qeveria deri sot ka ndarë 317 mijë euro, përfshirë edhe shumën prej 115 mijë e 740 euro të ndara me vendim të qeverisë më 26 shkurt 2019, për rezultatet e punës së këtij komisioni nuk kemi nevojë të shtojmë asgjë sepse janë të njohura tashmë.

Edhe pse vendi ynë ka dikaster të veçantë për minoritete, për pakica, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, kjo Qeveri vendos që nga rezerva shtetërore të akomodojë kërkesat dhe nevojat e tyre.

Mbi një milion e 800 mijë euro është shuma e mjeteve që janë ndarë me vendime qeveritare për nevoja të ndryshme për komunitete që jetojnë në Kosovë nga pagesat e qirave për zyrat e OJQ-ve, dhuratat për festat e fundvitit, deri te pakot higjienike.

Përmes kësaj praktike, e kam thënë edhe herën e kaluar, po dëshmohet se kjo Qeveri zhvat paranë publike edhe në letra tualeti.

Po nga fondi i rezervave shtetërore, kjo qeveri ka ndarë rreth një milion e 600 mijë euro edhe për kategoritë e dala nga lufta.

Nga ana tjetër, përderisa Qeveria pa asnjë kriter shpërndan para për filma, për festime luksi, për kompensime shtesë dhe stimulim financiar, ajo injoron në tërësi rastet kur fatkeqësia u vjen nga Zoti.



Katër fshatra të komunës së Prizrenit, Medveci, Zojzi, Pirana, Smaçi, në gusht të vitit 2018 ishin vërshuar mbi 80 hektarë tokë të mbjella me perime, sera bujqësore, ishin dëmtuar rrugët fushore, muret mbrojtëse, ura mbi lumin Toplluha, shkolla, Qendra Kulturore Sportive dhe përgjigjen që morën banorët nga Qeveria ishte: Qeveria nuk ka para!

Të nderuar deputetë,

Ndarja e kaq shumë fondeve për kaq shumë kategori nga rezerva shtetërore pa asnjë planifikim paraprak nxjerr dy përfundime:

E para, që Qeveria aktuale ka logjikën dhe kulturën zhvatese dhe abuzuese të parasë publike, dhe

E dyta, kjo Qeveri nuk ka kapacitete as për planifikim, as për zbatim të politikave qeveritare.

Praktika e tillë është tejet e dëmshme për menaxhimin e parasë së taksapaguesve kosovarë dhe pengon rëndë zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Në fund, të nderuar kolegë deputetë,

Pas debatit që do të zhvillohet, Kuvendit të Kosovës i propozohet miratimi i një rezolute me dy pika:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta ndalë menjëherë praktikën e ndarjes së mjeteve financiare pa kritere dhe pa respektuar dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe dy minuta, regjia.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Dhe, nën dy:

2. Në afat prej një jave Qeveria, përkatësisht Zyra e Kryeministrit të sjellë në Kuvend një raport të detajuar për procedurat e zhvilluara për përzgjedhjen e kompanive, të cilat kanë realizuar aktivitetet dhe një raport me të dhënat specifike për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve.

Raporti duhet të fokusohet në tri ngjarje kryesore: shënimi i përvjetorëve të pavarësisë për vitin 2018 dhe 2019 si dhe shënimi i 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Jemi të hapur për plotësimin eventual të kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selmanaj!

Duhet ta shpërndani projekt-rezolutën, për ndryshe deputetët s'mund të vendosin nëse donë të votojnë ose jo.

Zoti Haradinaj, sipas rregullit, pas grupeve parlamentare mund ta merrni ju fjalën. Jo, grupet parlamentare, pastaj kryeministri. Në qoftë se do, unë s'e kam problem të ta jap fjalën, veç si rregull është kjo. Një herë grupet parlamentare, tani përfaqësuesit.

Atëherë, zonja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, po shkoj kështu me radhë qysh janë paraqitur.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke u përpjekur për të qenë në top agjendë partitë opozitare shpeshherë kanë mbledhur nënshkrime për të bërë seanca koti, kanë thirrur seancë duke përhapur dezinformata se po shkatërrohet shteti, kanë futur frikë e panik te qytetarët, në vend që të tregohen unik në raport me interesat e shtetit, të marrin pjesë në ekipin negociator.

Këta kanë thirrur seanca që kanë thelluar më tutje ndarjen e faktorit shqiptar që askujt nuk i shkon për shtati një gjë e tillë, pos atyre që duan ta shkatërrojnë shtetin e Kosovës.

Është kërkuar me urgjencë në ditën e Epopesë së Jasharajve të mbahet kjo seancë, prapë me propagandën e madhe se po ik rezerva e shtetit, po rrezikohet vendi financiarisht, mirëpo e mira e kësaj çështje është që nuk është mbajtur atë ditë kjo seancë në ditën e shënuar të historisë së kombit tonë, por është shtyrë për sot dhe e gjithë kjo bëhet me apo pa argumente politike, me apo pa argumente të shifrave, vetëm sa për të bërë zhurmë e të mbajnë në tension qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me shpenzimin e rezervës së Qeverisë nuk rrezikohet stabiliteti makro-fiskal, nuk rrezikohet shteti, nuk bie vendi në krizë financiare, por është shumë me rëndësishme që për shpenzimin e këtij kodi buxhetor për mjete rezervë të respektohet ligji, të ketë transparencë dhe llogaridhënie.

Çdo ditë e më shumë në këtë Kuvend po thellohet fjalori fyes e denigruës nga deputetët opozitarë. T'i thuash dikujt hajn, kriminel, abuzues pa fakte, është fyerje, por edhe është e ndaluar me ligj.

Dy partitë opozitare na dalin këtu si engjëj, e në fakt nuk lënë gjë pa bërë vetë, duke mos respektuar as ligj, as rregull, e duke nëpërkëmbur vlerat e shtetit.

Partia opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës sikur do të largohet nga llogaridhënia, pasi deri para një vit e gjysmë ka vendosur vetë se ku, si dhe për çfarë do t'i ndajë mjetet, të cilat i ka planifikuar dhe shpenzuar në buxhetin e Republikës së Kosovës, duke qenë vetë menaxhues kryesor dhe përgjegjësit e buxhetit. Edhe vitin e kaluar, edhe gjatë këtij viti Lidhja Demokratike e Kosovës është shumë e shqetësuar për ndarjen e mjeteve për shpenzimet e paparashikuara, por kjo formë e shpenzimit të këtyre mjeteve nuk po ndryshon shumë nga koha kur ka qenë ministër shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kryeministër kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ndërsa, ai e di si ka abuzuar vetë me shpenzimet nga ky fond kur ka qenë ministër dhe tash ka perceptcion që po veprohet njëjtë, siç ka vepruar ai. Rregullat janë të njëjta e përgjegjësia është e njëjtë, si tani, si atëherë për shpenzimet e këtyre mjeteve.

Nëse i referoheni historikut të shpenzimeve të mjeteve të parapara për shpenzimet e paparashikuara nga viti 2013 deri në vitin 2017, pothuajse njëjtë është shpenzuar, është shfrytëzuar fondi rezervë i Qeverisë. Mesatarja e viteve të fundit del të jetë 7 deri 8 milionë euro brenda vitit. Në vitin 2016, kur ka qenë ministër zoti Hoti, janë shpenzuar hiç më pak se 8.1 milionë euro, kurse në vitin 2017 janë shpenzuar 7 milionë euro, kurse në vitin 2018 janë shpenzuar 4.6 milionë euro dhe nëse i shikojmë se si është shpenzuar ky kod buxhetor, është gati se i njëjtë siç po bëhet shpenzimi edhe tani.

Të nderuar deputetë,

Ne Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nuk do donim të shpenzohet kështu me një formë të njëjtë të shpenzimeve të mjeteve në kodin për shpenzimet e paparashikuara edhe në këtë qeveri. Ne do të donim që të adresohet më mirë kjo çështje siç janë adresuar dhe shumë çështje të tjera. Shqetësimet tona i kemi ngrit edhe kryesisht kanë të bëjnë me planifikimin dhe procedurat dhe jemi munduar të kontribuojmë që paraja publike duhet të planifikohet mirë dhe duhet të shpenzohet në mënyrë të kujdesshme. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë edhe tani që Qeveria të jetë e kujdesshme, t'i planifikojë gjërat me kohë për ngjarjet, të cilat dihen që do të ndodhin çdo vit, ato ngjarje duhet të planifikohen përmes kodeve buxhetore. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike jemi të interesuar dhe të angazhuar që çdo cent i parasë publike të shpenzohet me kujdes në bazë të rregullativës ligjore, si dhe planifikimeve buxhetore. Shpenzimi i parasë publike të bëhet me transparencë, efikasitet dhe efektivitet.

Është bërë shumë zhurmë për këtë fond edhe në vitin e kaluar, siç e dimë, e di edhe vetë opozita, se pjesa më e madhe e kësaj rezerve, diku 50% është shpenzuar për të adresuar përkohësisht çështjen e KOSTT-it. Kjo qeveri e ka trashëguar këtë problem nga e kaluar që nuk ka bërë asgjë për të adresuar dhe zgjidhur këtë problem, duke e ditur situatën që është krijuar pas çështjes që është ngrit nga Ombudspersoni, shkyçja e linjave interkonjektive të Kosovës nga vendet fqinje kanë nënkuptuar izolimin e tërë sistemit elektro-energjetik të Kosovës si pasojë e kësaj ky i fundit vështirë do të mund të operonte i izoluar për shkak të parametrave teknike, në këtë rast të gjithë konsumatorët e Kosovës do të mbeteshin pa energji elektrike. Kjo do të cenonte

funksionimin e vendit si konkluzion e reputacioni i KOSTT-it do të rrënohej, i cili tash është i cenuar seriozisht, do t'i pamundësohej KOSTT-it të fillojë implementimin e marrëveshjes për kyçje në rrjetin evropian të operatorëve të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike.

Kam lexuar nëpër portale një deklaram të zotit Hoti se Ligji për financa publike specifikon kushtet që duhet plotësuar, në mënyrë që Qeveria e Kosovës të ketë të drejtë të ndajë mjete nga rezerva shtetërore, si në situata të vërshimeve, në situata të paparashikueshme, në projekte në të cilat nuk ka pasur mundësi të parashihen paraprakisht në buxhetin e rregullt. Dhe, sa herë që Qeveria ndan mjete të tilla gjithmonë duhet të jetë një opinion i ministrit të Financave që analizon situatën, e sheh se ka bazë ligjore për ndarjen e mjeteve të tilla, pra sipas tij ky është shpërdorim i madh i buxhetit të shtetit. Pyes zotin Hoti: a ka respektuar rregulla të tilla që i ka përcaktuar ligji kur ai ka qenë ministër? A e ka dhënë opinionin e tij për bazën ligjore? Sigurisht se jo! Unë e kam bërë një analizë të të gjitha vendimeve të marra për ndarjen e mjeteve nga fondi rezervë për vitet 2015, 2016 dhe 2017. Po ndalem te viti 2016, ku janë shpenzuar 8 milionë e 178 mijë e 741 euro. Për dëmet nga vërshimet kam vërejtur se janë ndarë vetëm 159 mijë e 480 euro komunave që kanë pësuar nga këto vërshime dhe 50 mijë euro kanë shkuar ndihmë për vërshimet, të cilat kanë ndodhur në shtetin fqinj, në Maqedoni.

Unë kam bërë një analizë edhe këtu, ja ku e kam, të gjitha i kam nxjerrë vendimet, të cilat kanë ndodhur brenda këtij viti. Asnjë vendim nuk e ka respektuar ashtu siç kërkon zoti Hoti, Ligjin për financat publike. U përmend këtu realizimi i një filmi, se s'po di sot e dëgjova këtu, në vitin 2016 në Kodin 107 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për realizimin e planit të subvencionimit të projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës ka ndarë 250 mijë euro. Se në çfarë filmash kanë shkuar këta apo ku kanë shkuar, nuk ka të dhëna të detajuara, kurse e shohin të ndarë që për filmin "Shok", të cilin e kemi parë përmes televizionit, për këtë film janë ndarë diku 70 mijë euro me vendimin e Qeverisë 10/72. Nëse i shohim vendimet, të cilat janë marrë në vitin 2016 janë ndarë mjete për përvjetorin e pavarësisë, për 8-vjetorin e pavarësisë, shohim se janë ndarë mjete edhe për Epopenë e Jasharajve, njëjtë siç po ndahen tash vite me radhë, shohim se janë ndarë edhe për njerëzit, të cilët kanë qenë të sëmurë nga kanceri dhe janë shëruar jashtë vendit, shohim se janë ndarë edhe për mëditje të personave të ndryshëm të institucioneve të ndryshme, e ka lloj-lloj shpenzime të cilat i kam shikuar një nga një në vitin 2016.

Të nderuar deputetë,

Duke njohur punën me shumë profesionalizëm të ministrit të Financave, zotit Bedri Hamza, duke njohur angazhimin dhe menaxhimin që u ka bërë financave publike për vite të tëra, unë e di që nuk do të lejojë të shpenzohen mjetet në mënyrë arbitrare, pa kriter dhe me dorë të lirë, siç po theksohet nga opozita në takime të ndryshme. Kam vlerësuar dhe vlerësoj ...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Ti ia paske marrë minutat Qeverisë, po flet në emër të Qeverisë, po më duket. Merri edhe 2 minuta, meqenëse edhe këtyre ua shtova, vazhdo!

SAFETE HADERGJONAJ: Kam vlerësuar dhe vlerësoj edhe ngritjen e shqetësimit, të cilin në vazhdimësi e ka ngritur në Qeveri zoti ministër, duke u tërheq vërejtjen të gjithëve që çdo shpenzim duhet të planifikohet paraprakisht.

Ne si grup parlamentar jemi të angazhuar që të kontribuojmë në menaxhimin me efikasitet dhe efektivitet të financave publike. Angazhimi ynë është që të ketë transparencë dhe llogaridhënie, Qeveria duhet të respektojë strikt ligjin në rast të shpenzimit të këtyre mjeteve. Insistimi ynë është që çdo çështje, e cila dihet paraprakisht, të jetë pjesë e planifikimit të buxhetit dhe ngjarje të caktuara që po mbahen nën patronatin e Qeverisë dhe Kryeministrit, ato që po mbahen për çdo vit, duhet të bëhen pjesë e kodeve buxhetore që të mos ketë nevojë nga viti në vit të përsëritet ndarja e tillë e mjeteve nga fondi i shpenzimeve të paparashikuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,  
Të dashur qytetarë të Republikës,

Po këtu kemi të bëjmë me, së pari, shqyrtimin e Ligjit për financat dhe përgjegjësitë, dhe aty ma merr mendja që neni 29 është shumë i qartë, nëse e lexojmë ligjin dhe ne këtu po pretendojmë për shkelje të ligjit dhe, së pari për keqpërdorime ligjore, pastaj edhe për keqpërdorime financiare, sepse lihet hapësirë për keqpërdorime financiare.

Dy pikat e para të mënyrës se si shtrohet aplikimi për të argumentuar shpenzimin prej fondit, i cili është i dedikuar për këtë qëllim, pra për shpenzime urgjente, dy pikat e para janë kryesore dhe tregojnë saktë se qysh shkon kjo procedurë. Për mendimin tim, janë pikat më të rëndësishme. E para, që shpjegohen rrethanat për këto fonde, arsyeshmërinë dhe e dyta, shpjegohet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen. Kjo është pika një dhe dy e ligjit sa i përket arsyeshmërisë së shpenzimit të fondeve urgjente dhe të paparashikuara. Tash, ajo çka është tronditëse ka të bëjë me festën e pavarësisë. Kjo qeveri nuk e di kur është pavarësia e Kosovës apo qysh është puna! A e di që data e pavarësisë së Kosovës nuk luan, për çdo vit është me 17 shkurt, qysh më kujtohet! Qysh është e mundur që shpenzimet për pavarësi gjithmonë të shpenzohen prej këtij fondi dhe gjithmonë me lëkundje shumë të mëdha financiare. Domethënë, një vit i harxhojmë 200 mijë euro, vitin tjetër 500 mijë euro, kurrkush nuk jep llogari, një emblemë e thjeshtë është paguar gati 5 euro! Ku doni shkoni e shikoni, ajo emblemë kushton mes 50 cent edhe 1 euro, maksimumi, se ka edhe më të lira. Ajo emblemë vetëm nëse është e veshur me arë, se përndryshe nuk ka kuptim ai çmim ashtu. Lihet mundësia për keqpërdorime të

hatashme, edhe tenderi edhe për pavarësi jepet që të kënaqet ndonjë militant, të cilit i jepet ky tender. E, për çfarë ngjarje? Për pavarësinë e Kosovës! Kjo është e gërditshme!

Këtu në Kosovë kemi dy lloje të keqpërdorimeve: janë ato keqpërdorimet në këtë stilin e tenderëve, me presion, me direktiva, me manipulime të ndryshme, qysh e kemi parë rastin, kurrkush nuk ka iluzione këtu në Kosovë, pasi e ka parë rastin e Blerim Dinës çka i ka ndodhur, i kanë shkuar njerëzit në banesë private në pikë të ditës dhe ia kanë lypur tenderin mbi 20 milionë euro për autostradën Prishtinë – Gjilan, ministri i Punëve të Brendshme ka qenë aty, i ka shkuar t’ia lyp tenderin. Kryetarit të organit të OSHP-së, të Organit Shqyrtues të Prokurimit, kanë shkuar në pikë të ditës, në vitin 2017, ata njerëz janë liruar prej gjykatës, kjo i bien kurrgjë kurrkujt. Kësi lloj keqpërdorimesh në Kosovë, çdo javë ndodhin në Kosovë, keqpërdorime të mëdha me dhjetëra milionë euro, si Bechtel&Enka, si shpenzimet për Bechtel&Enkën, apo sikur vendimi i paligjshëm për lirimin nga borxhet e kompanive të ujit.

Mirëpo, ne sot jemi mbledhur jo të flasim për këto keqpërdorime, por vetëm për këtë llojin e keqpërdorimeve që lidhet me rezervën shtetërore dhe me shpenzimet e paparashikuara. Për shembull, keni dhënë shpenzime të paparashikuara për presidentin. Qysh është e mundur kjo? Qysh është e mundur shteti i Kosovës të japë qindra-mijëra euro për lobimin personal të Presidentit? A ua ka shtruar kusht Presidenti për koalicion, a qysh është puna? Sa herë të lyp ai para, t’i jepen prej buxhetit të shtetit të Kosovës, për çka? Për librat e tij personal, edhe për lobimin e tij personal! Çka na intereson neve, ai le të themi, lobimi për figurën personale të Hashim Thaçit. Pse të paguajnë taksapaguesit e Kosovës? E prej kujt? Prej rezervës shtetërore, prej asaj që është e dedikuar veç kur ndodh ndonjë katastrofë humanitare, a ndonjë katastrofë natyrore.

Ne të paguajmë për Presidentin, kontrata me “Balarden and Partners” e Presidentit të Republikës së Kosovës është 1.2 milion euro, 1.2 milion euro ju, qytetarë të Kosovës, i keni paguar për Presidentin që ai të endet poshtë e përpjetë, e jo vetëm të promovojë emrin e tij personal me libra privatë, por edhe të llojë për ndarjen e Kosovës. Këto para prej rezervës shfrytëzohen edhe për këtë gjë. Mos marroni! Kjo është e pikëllueshme. Kjo nuk guxon të ndodhë.

Tjetra? Keni dhënë para lidhje pa lidhje për projekte për të cilën nuk ka asnjë përgjegjësi. A po më tregoni çka ka bërë Korporata e Mijëvjeçarit në Kosovë? Numëromëni arritjet çka ka bërë Korporata e Mijëvjeçarit në Kosovë. Ku i ka vënë objektivat dhe ku janë rezultatet sot? 200 mijë euro kanë shkuar për këtë projekt asgjë askujt.

Tjetra. U përmend edhe prej folësës së PDK-së që paska dhënë edhe Qeveria e kaluar për filmin ‘Shok’ 70 mijë euro, po veç, se nuk jam këtu ta mbrojë Qeverinë e kaluar, nuk po ia fsheh keqpërdorimet as qeverive të kaluara. Mund të ketë pasur keqpërdorime, edhe i kemi përmendur. Unë nuk kam përtuar kurrë t’i përmend në këtë Parlament. Edhe ndonjë keqpërdorim të Qeverisë

Mustafa. Mirëpo, mos harroni filmi 'Shok' ka shkuar në Hollivud, a ju po flisni për një film të cilit ia keni dhënë 180 mijë euro, a Komisioni zyrtar shtetëror i Kosovës e ka shpallur filmin e 12-të. Në vend se t'ia jepni paratë filmit të parë apo të dytë, ju ia keni dhënë paratë filmit të 12-të. Aty janë mbledhur një juri profesionale, i kanë vlerësuar filmat dhe kanë thënë prej 14 filmave që kanë konkurruar, ky është gati i fundit, më i dobëti. Dhe, keni shkuar filmit më të dobët ia keni dhënë 180 mijë euro. Pse po bëni këso krahasimesh të paqëndrueshme?

Filmi 'Shok' ka shkuar në finale të Hollivudit. Nuk e ka fituar çmimin, por ka qenë në konkurrencën e ngushtë finale, përfundimtare. Ka mundur ta fitojë çmimin 'Oscar', kursi të po më bën këtu krahasime me një film i cili është s'po e di. Juria, unë nuk jam profesionist, unë po flas me fjalë të Komisionit. Ata njerëz tërë jetën janë përgatitur akademikisht për t'i vlerësuar filmat. Ose po e lëmë këtë punë krejt. Po ua shtimë drynin atyre komisioneve të kulturës. Për çka ekziston ai Komision? E ka shpallur filmin i 12-ti, filmi merr çmimin e Qeverisë. Kjo është hajgare. Ose po bëhemi si duhet shtet, e po ia japim paratë filmit të parë, ose mbyllemi atë Komision, çka po ju duhet. Puna e tij është kot, të vlerësosh diçka që Qeveria në këtë vesh hyn, në tjetrin del.

Tjetra. Një projekt shumë interesant, qysh jepen para prej fondit rezervë. Se unë mendoj se prej këtij fondi rezervë, ashtu siç e lexova ligjin, për besë, shumë kujdes duhet pasur kur të vendoset ku po do t'i qosh ato para. Shumë kujdes i madh është aty. Nuk e kam aty që tha znj. Hadërgjonaj që tash po destabilizohet shteti i Kosovës, apo po kolapson. Po kulturë është kjo, kulturë e shtetndërtimit. Po i merr paratë rreth 200-300 mijë euro, 400 mijë euro, nuk e ke gjale prej fondit rezervë, edhe çka po i jep, po thotë programi nacional për rini. Programi nacional për rini, shih çfarë emri i bukur? Programi nacional për rini. Po t'ju pyes çka ka bërë ky Programi nacional për rininë, për besë asnjë fjali nuk je në gjendje të ma tregosh. 200 mijë euro i ka marrë bre. 200 mijë këtu, 400 mijë atje, 300 mijë këtu, po bëhen miliona kështu të qytetarëve të Kosovës. Shikojeni se në çfarë mënyre po harxhohen.

**KRYESUESI:** Faleminderit edhe për saktësinë në përfundimin e diskutimit në raport me kohën. Fjalën e ka zoti Kuçi në emër të AAK-së.

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, nënkryetar!

E para, normalisht që kam vërejtjet e mia për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme. E dyta ka të bëjë me një vendim të Qeverisë i cili shumë mirë i referohet neneve dhe ligjeve të caktuara. Edhe mesa kemi vërejtur ne, asnjë pjesë e asnjë ligji nuk është shkelur për marrjen e një vendimi të tillë. Pra nuk është shkelur as Ligji për buxhet, as Ligji për menaxhimin e Financave publike. Vendimi i Qeverisë i referohet neneve të caktuara. Për deputetët të cilët nuk e kanë kohën e duhur, ose njohuritë e duhura, vetëm duhet t'i referohen nenit të caktuar, edhe e shohin a është shkelur ligji apo jo.

Në marrjen e këtij vendimi asnjë nen e asnjë pjesë e asnjë ligjit nuk është shkelur. Në qoftë se po flasim për moral, edhe për politikë, është diçka tjetër. Por, ajo që më çudit edhe që është e çuditshme, edhe kryetari i Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, që është zoti Driton Selmani. Ai e di që Kuvendi ka një mekanizëm shtetëror, që quhet Auditori i përgjithshëm. Ai shumë mirë e di sepse Komisioni që e udhëheq ai, i jep raporte mjaft të shpeshta Auditori i Përgjithshëm. Edhe ka pasur të drejtë ta thërrasë Auditorin e Përgjithshëm, edhe të kërkojë, të rekomandojë të bëjë një auditim në Qeveri, që nuk e ka bërë, po kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme.

Habia prapë tjetër, zoti Abdixhiku është kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku jam edhe unë anëtar i këtij Komisioni, edhe asnjëherë nuk kemi thirrur të shohim që Qeveria me vendimin përkatës a e ka shkelur ligjin. Po ta kishte thirrur, kishim debatuar në atë Komision, edhe e kishim bërë shumë të qartë që ligji nuk është shkelur, as Ligji për Buxhet, as Ligji për menaxhimin e financave publike. Mirëpo, kjo nguti, pa kaluar nëpër këto faza është e gabueshme. Sepse sot kemi mundur ta kemi një raport të Auditorit të Përgjithshëm për këtë çështje dhe të debatojmë, e assesi të thirret seancë e jashtëzakonshme. Pse ngutet, pse po ngutemi, për mua është e çuditshme. Pra, ligjet, as Ligji për menaxhimin e financave publike, as Ligji për buxhet nuk është shkelur me marrjen e këtij vendimi. Edhe normalisht, e tha edhe Safetja ministri është i vetëdijshëm, edhe e ka pasur parasysh edhe nenet, edhe paragrafët e neneve që është thirrur në to, që nuk janë shkelur. Pra, Qeveria ka marrë një vendim të ligjshëm. A është moral, apo i duhuri, është përgjegjësi e Qeverisë, po assesi nuk munden të na shesin moral ata të cilët thirrin seancë të jashtëzakonshme për këtë çështje.

Ne jemi duke pritur të kemi raportin e shpenzimeve për vitin 2018, edhe kishim parë sesi ishin menaxhuar paratë nga e Qeverisë, përmes raportit të shpenzimeve kemi pasur një debat që ashtukështu ka me qenë, edhe kishim debatuar për këtë çështje.

Sa i përket moralit, edhe një herë bëj pyetje, a është e moralshme të thirret Kuvendi për një vendim ligjor të Qeverisë, për një vendim ligjor të Qeverisë në seancë të jashtëzakonshme. Cila është më e moralshme? Të thërrasësh seancë të jashtëzakonshme për një vendim që Qeveria e ka marrë, edhe vendim krejtësisht të ligjshëm, unë mendoj se nuk është e moralshme të na thirrni sot në një seancë të jashtëzakonshme.

Për mënyrën e procedimit të shpenzimeve, nuk është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme, është thirrur për çështjen e ndarjeve buxhetore. Por, edhe të ishte thirrur, ne nuk kemi pasur si ta shqyrtojmë pa e parë raportin e Auditorit. Kryetari i Komisionit, zoti Selmani, si kryetar i Komisionit, është dashur ta thërrasë Auditorin e Përgjithshëm, t'i rekomandojë të ketë një audit që sot të vijmë të bisedojmë për këtë temë. Kjo nuk është më çudi, sepse në seanca të jashtëzakonshme ne po thirremi për çkado, dhe duhet si Kuvend, po ashtu ndoshta të marrim një rezolutë, edhe një rekomandim kur thirret Kuvendi në seanca të jashtëzakonshme.



Kryesues, unë po e propozoj një rekomandim që sot Kuvendit të vendosë kur duhet të thirremi për të ardhur në seanca të jashtëzakonshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Driton Selmanaj!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Në fakt, nëse dëgjohej me kujdes zoti Kuçi, logjika e fjalimit të tij është kështu. Keqpërdorime ka pasur shumë, po me letra i kemi mbuluar. Pra, po na thotë me letra është mirë, ju lutem, po kemi bërë ne diçka aty, po tekefundit mos ia nxirr fundin, se me letra jemi mirë. Po, jo, nuk guxojmë ne kështu me këtë logjikë të shkojmë.

Edhe çështja tjetër, nëse mendohet këtu që me raporte të auditorit. Veç një sekondë! Raportet e Auditorit na vijnë çdo ditë neve në trajtim, por raportet e Auditorit kanë mostër sesi auditojnë një institucion, dhe shpeshherë, çështjet për të cilat ne kemi interes nuk janë hiç në raport të Auditorit, sepse nuk ka ra mostra. P.sh. për çështjen që kemi diskutuar edhe për vitin e kaluar, nuk është në raportin e Auditorit çështja sesi është shpenzuar paraja publike, p.sh. për rastin e 600 mijë eurove, ose 500 eurove, për rastin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Prandaj, ne nuk duhet të varemi vetëm nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, por duhet të diskutojmë për secilin cent që ne dyshojmë se kjo Qeveri po abuzon dhe për të cilën kemi fakte të mjaftueshme për këtë. Çështja për të cilën po thotë urgjenca, po ne e kemi ftuar Kryeministrin në Komision për mbikëqyrje të financave publike, për ta diskutuar këtë temë, nuk ka ardhur. E ka dërguar Haki Shatrin si këshilltar. Madje, as ministrin e Financave jo. S'mund të diskutojmë me këshilltarë që i keni 400 nëpër zyrat tuaja, sepse është degradim i institucionit më të lartë kushtetues në Kosovë. Nuk guxojmë kështu.

Për ta thirrur seancën e jashtëzakonshme ka qenë instrument i domosdoshëm yni. Përndryshe, ju po vazhdoni edhe më tutje, abuzoni edhe puna e mbarë ju qoftë.

KRYESUESI: Zoti Kuçi, kundër-replikë!

BLERIM KUÇI: Po e shoh që në aspektin ligjor Dritonit nuk po i pëlqen të hyjë në debat, po unë atëherë dua ta them një mesele. Në kohën e fashizmit, Marka Zefi edhe Tahir Beerisha komunikojnë përmes njëlloj vjershe, edhe Marka Zefi gëzohet që ka hyrë fashizmi në Kosovë edhe i thotë: "Moj e mira që shkon me shqerra, të lumtë ne na erdh pranvera". Tahir Berisha ia kthen po ashtu me një vjershë: "Moj e mira që shkon me dhen, tërta-vërta kurrë një send". Ju me këtë çështje keni bërë bash "tërta-vërta kurrë një send". Na e keni prishur konceptin e seancave të jashtëzakonshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit kryesues!

Shpresoj që t'i kthehem mënyrës së komunikimit edhe nivelit parlamentar të diskutimit në këtë Kuvend.

Sa i përket çështjes në fjalë, zoti Selmanaj prezantoi këtu një varg të dhënash të cilat jo vetëm që janë të papranueshme, por janë edhe shqetësuese për mënyrën se si po ndahen fillimisht, e pastaj edhe si shpenzohet paraja publike.

Si subjekt socialdemokrat, fillimisht në fakt se do t'i shpërndanim ndryshe edhe këto para. Pra në vend se të shkojnë për festa, e për shënime të përvjetorëve të cilët ndonjëherë edhe janë të nevojshme, ndoshta më mirë do të ishte që ato të shkonin për çerdhe, edhe sidomos për projekte për mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë po aq edhe më shumë të nevojshme. Shënimi i festave përveç që ka dështuar të promovojë shtetësinë tonë, shpeshherë i ka vënë në pah edhe dështimet e protokollit të shtetit, që nganjëherë na kanë vënë edhe në situata të sikletshme.

Për pretendimet që zoti Selmanaj i prezantoi këtu, ne ende nuk kemi fakte të mjaftueshme, prandaj Kuvendi do të duhej që fillimisht t'i posedonte këto fakte, të cilat do të mund të siguroheshin ose duke iu ofruar to vetë Qeveria, ose përmes mekanizmave të tjerë të cilët i ka Kuvendi, nëpërmjet procedurave hetimore, të cilat i parasheh edhe Rregullorja. Por, vetëm miratimi i një rezolute mendojmë që është i pamjaftueshëm. Këtë e kanë thënë disa herë edhe kolegët tanë, sepse rezoluta nuk e ka detyruar Qeverinë t'u përmbahet atyre, sepse nuk ka mekanizma të tillë.

Në anën tjetër, zonja Hadërgjonaj po ashtu prezantoi të dhëna të ngjashme për keqpërdorime të pretenduara po aq shqetësuese të cilat janë bërë në kohën sa partia e saj ka qenë në koalicion me PDK-në. Megjithatë, fakti se ka pasur keqpërdorime edhe abuzime me paranë publike në kohën kur PDK ka qeverisur me LDK-në, as nuk e arsyeton e as nuk e shfajëson tani Qeverinë e PDK-së me AAK-në. Prandaj, për ty dyja këto pretendime duhet që përveç Kuvendit të merret edhe Prokuroria, e cila duhet t'i fillojë menjëherë hetimet dhe përgjegjësit të japim llogari, dhe atë jo vetëm për këto keqpërdorime, jo vetëm keqpërdorimet dhe abuzimet e bëra nga kjo Qeveri, por në vazhdimësi. Pra, këto keqpërdorime po e dëmtojnë buxhetin, por është shqetësues fakti se ato po e ulin në masë besimin e qytetarëve te institucionet shtetërore në përgjithësi.

Prandaj, ne do të donim që rezoluta të plotësohej edhe me çështje tjera dhe mbi të gjitha me fillimin e procedurave hetimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e zotit Sherifi në emër të Nismës Socialdemokrate.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë do të përpiqem të flas shkurt, sepse kjo seancë për mendimin tim do duhej të kishte tjetër radhitje. Kemi pretendime të ngritura nga 40 deputetë të cilat u lexuan këtu, i dëgjuam, dhe radha do duhej të ishte së paku për nga këndvështrimi im e i Qeverisë, që të japin qëndrimin e tyre, pikëpamjet e tyre, versionin e tyre, pastaj të përfshihemi grepet parlamentare dhe deputetët në debatin e mëtejshëm.

Unë nuk di çka them tash nga këto që i dëgjova, para se ta dëgjoj Qeverinë. Kur ta dëgjoj Qeverinë, qoftë ministrin e Financave, qoftë kryeministrin, mund ta krijoj në ide se çka qëndron dhe çka nuk qëndron në krejt këtë. Pra, çka është propagandë dhe çka është zell i madh për ta mbrojtur buxhetin dhe ligjin.

Pra, unë do të rezervohem që të flas pasi ta dëgjoj edhe pozicionin e Qeverisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjala është e kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARDAINAJ:** Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Zëvendëskryeministër Pacolli,

I nderuar ministër Hamza,

Të nderuara media,

Thënë të drejtën, ndoshta është praktikë parlamentare kur është palë Qeveria, pra kur flitet për një temë dhe është t'i jepet Qeverisë ndoshta menjëherë pas sponsorizuesit të temës, pikërisht për shkak të debatit në mënyrë që të dëgjohen argumentet dhe kundër-argumentet pastaj të vazhdojë diskutimi, po edhe kështu bën në këtë formë.

Unë i kam dy aspekte të cilat dua t'i sjell para jush, për shkak se me kompetencë të plotë do të flasë ministri i Financave, zoti Bedri Hamza për të cilin kam respekt realisht si profesionist edhe si njeri, po edhe si koleg ministër.

E para është kjo; diskutimet që kanë ndodhur në publik për festimin e 11-vjetorit të pavarësisë. Po jua lexoj krejt materialin, po ju them me dy-tri fjalë sesi është gjendja. Paratë janë ndarë ngase është propozuar në Qeveri nga Ministria e Jashtme. Paratë e ndara janë bartur ose i janë dedikuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Aktivitete e parapara i ka bërë mekanizmi i paraparë i Protokollit të Shtetit për ngjarjet që pasojnë. Me sa unë jam në dijeni, kostoja e shpenzimeve për 11-vjetorin e pavarësisë është rreth 175 mijë euro. Pra, para janë ndarë më shumë, mirëpo të gjitha të tjerat kthehen në buxhet.

Unë kam kërkuar një auditim të brendshëm edhe Auditorin e Përgjithshëm, pasi që është diskutuar në publik, të shihet të e vërteta cilado qoftë ajo, ngase ju siguroj që shumica e

personelit që punon në Zyrën e Kryeministrit nuk janë nga Aleanca, madje as të PDK-së. Ka aty të LDK-së që janë aty kaherë. Ka pa parti, pra janë 300-400 njerëz në Kryeministri, ose 500 sa janë aty.

Unë kam kërkuar një auditim që në mënyrë që të shihet e vërteta, po e quaj ashtu pa asnjë paragjykim.

Sa i përket çështjes së shpenzimeve, pra të paparapara, në Kosovë ekziston një praktikë tashmë e vendosur, për shembull në vitin 2016 kanë qenë të ndara shpenzime të paparapara, 8 milionë e 178 mijë e 741 euro, janë shpenzuar 8 milionë e 124 mijë e 976 euro.

Më herët më është thënë se ka qenë vit zgjedhor, në fakt viti 2016 s'ka pasur zgjedhje. Në vitin 2017 po, ndërkaq në vitin 2016, jo.

E kemi vitin 2017, 7 milionë e 40 mijë dhe janë shpenzuar 6 milionë e 965 mijë. Pse fola për këtë? Fola vetëm t'ju raportoj të nderuar kolegë, që është një praktikë e vazhdueshme e qeverive paraprake; PDK, LDK, tani edhe Qeveria Haradinaj të njëjtën praktikë e ndjekë.

Të gjitha vendimet që merren për fat të mirë janë transparente. Pra, s'mund të ketë vendime jo transparente dhe disa prej këtyre vendimeve nuk bëjnë përjashtim.

U cek nga Glauku me të drejtë filmi 'Shok', po u harrua se aty afër janë edhe 250 mijë të tjera për Kosova Filmin, pra për të gjitha projektet tjera, bash në atë kohë. Pra, është një praktikë që vazhdon e të cilën nuk e kam vendosur unë. Pra, nuk është një rregull i vendosur nga kryeministri Haradinaj.

Në të njëjtën kohë mund t'i gjeni në ato vite, nuk po dua të hyjë se është marre prej njerëzve dhe mund të gjeni që janë ndarë para me rastin e sëmundjeve të kancerit. Me rastin e kësaj apo të asaj, në praktikë pra, jo rregull i ri.

Unë e mirëpres diskutimin për shpenzimet dhe për ruajtjen e parasë së publikut. Mendoj që kjo është diçka e mirë që po e bën Parlamenti. A është se është seancë e jashtëzakonshme apo jo, kjo është diçka tjetër, por mendoj se kjo është një praktikë e mirë, pra të ballafaqohet Qeveria dhe nëse ka lëshimi apo të meta, duhet të ndodh jo vetëm përgjegjësia politike po edhe ligjore. Pra, në këtë rast, ju faleminderit për të gjitha që thatë ju. Do ta lusja ministrin, në qoftë se bën për pjesën e mbetur.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Meqenëse është koha e Qeverisë për sqarime mund ta marrë fjalën edhe ministri zoti Hamza. Do ta marrësh fjalën? Kujtim Shala e ka fjalën. Regjia, zotit Shala, nënkryetarit të Kuvendit ia jep fjalën!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Unë do të flas shumë shkurt dhe do të jap vetëm një sqarim, meqë e theksoi ehe kryeministri dhe tentoi të krijojë ekuivalencë me një rast të veçantë, tha; me financimin nga fondet nga shpenzimet e paparashikuara të një projekti filmi dhe foli për dy vendime të Qeverisë, e para që ka të bëjë me qendrën e kinematografisë dhe e dyta me procesin që quhej të lobimit për filmin ‘Shok’. Janë çështje krejtësisht të ndryshme.

Unë nuk do të diskutoj shumë arsyeshmërinë e marrjes së fondeve nga ai fond i veçantë të cilin me ligj Qeveria e përdorë kur e konsideron të nevojshme dhe kur e vlerëson që është e nevojshme. 250 mijë euro janë dhënë për programin e Qendrës Kinematografike të Kosovës që është agjencia e vetme në Kosovë e cila merret me atë punë.

Tani, unë dëshiroj të sqaroj që kur kjo qendër refuzon projekte të caktuara si në rastin e projektit filmit ‘Lojë jete’, asnjë institucion nuk ka të drejtë ta financojë nga fondet publike. Domethënë ky është problemi ligjor. Janë rastet krejtësisht të ndryshme.

Tani, nëse ka qenë e nevojshme apo e domosdoshme që programi i Qendrës Kinematografike të Kosovës atëherë të plotësohej të përplotësohej nga fondet e paparashikuara është çështje tjetër. Unë mendoj se si interpretim edhe atëherë ka qenë pak më i lirshëm, domethënë shkonte pak përtej normës strikte, por ai fond i jepej agjencisë, e cila merret me këto punë. Domethënë janë raste krejt të ndryshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar ministër,

Shumë të respektuar deputetë,

E para, dua t’i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre, mirëpo nuk dua të kuptohet që jam këtu për ta mbrojtur mënyrën e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parasë publike, çka do qoftë, për sa do centë qoftë jashtë rregullave edhe jashtë procedurave.

E kam thënë këtë edhe publikisht. E kam thënë këtë edhe në institucionin e Qeverisë. E kam thënë edhe në Kuvend, edhe vazhdoj të them kushdo që e kërkon, sepse kjo është detyre dhe punë e imja.

Mirëpo, kur flasim për shpenzimin e rezervës, me vete i kam të dhënat historike dhe nuk jam ndalur vetëm në qeverinë e kaluar kur ka qenë qeveria PDK-LDK, po kam shkuar edhe më tutje.

Nëse e shikojmë si nivel të shpenzimit del që shpenzimi i kësaj rezerve nëpër vite ka qenë në mesatare aty diku rreth 8 milionë me ndonjë plus ose minus. Edhe në vitin 2013. Edhe në vitin 2014. Edhe në vitin 2016. Kemi një rënie në vitin 2017. Dhe kemi një rënie në vitin 2018 në krahasim me vitin 2016.

Nëse hyjmë në strukturën e shpenzimit të kësaj rezerve, nuk dallon shumë nga viti në vit. Me vete i kam të dhënat e detajuara, zyrtare nëpër vite se për çka është shpenzuar rezerva.

Nëse shikojmë në vitin 2016, u përmenden disa sesi janë shpenzuar, por zakonisht është shpenzuar shënimi i 8-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Dallojnë shumat, mund të ketë në një vit më shumë dhe në një tjetër më pak.

Pastaj... Po edhe shumat i përmend. Po, po i përmend vetëm ta edhe përmendi edhe 8 milionë e 100. Dhe ta përmendi se më shumë është 8 milionë e 100 sesa 7 milionë, edhe ju pajtoheni më atë. Normalisht që pajtohesh.

Nëse hyjmë në strukturë... Jo për pavarësi jo, po si total dhe besoj që e di këtë edhe të paktë do duhej ta dije.

Do të thotë nuk janë më shumë 7 sesa 8. Tetë janë më shumë.

Nëse doni në strukturë, atëherë thotë; subvencionimi i projekteve filmike. Komisioni qeveritar për njohjen e statusit të të ish-dënuarve. Dëmet nga komunat, vërshimet dhe... Kontributi financiar për Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë e tjera e të tjera. Domethënë nuk dallon shumë as në strukturë e as në vlerë.

U përmend shpenzimi i parasë publike. Me vete i kam të dhënat. Nuk kemi përkeqësim në asnjë segment, në asnjë indikator makroekonomik gjatë kësaj qeverisje, përkundrazi kemi përmirësim.

Unë nuk jam gjithmonë që të minimizohet çdo lëshim. Çdo gabim. Çdo defekt. Jam që t'i them ato edhe jam që t'i luftojmë ato edhe jam që t'i pengojmë. Mirëpo nëse i referohemi të dhënave, atëherë del se... Po shikojmë fillimisht te rritja ekonomike. Nuk është rritja ekonomike më e madhe 4,1 se sa 4,2, prapë po them se nuk është e mjaftueshme, duhet të jetë më e madhe që të adresohen problemet e ekonomisë së Kosovës.

Po, kjo është ecuria e rritja ekonomike. Ky është grafiku i rritje ekonomike. Nëse vazhdojmë tutje edhe e shikojmë, ecuritë e inflacionit që nuk varen shumë prej nesh, po edhe të hyrat, kemi një rritje të vazhdueshme të të hyrave për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Nëse kalojmë te ekzekutimi i shpenzimeve kapitale, kemi një përmirësim të ekzekutimit të kapitale. Kur në Qeverinë e kaluar kemi pasur një rënie të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale, ndërsa tani kemi një ngritje të ekzekutimit të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale. Do të thotë përveç rritjes së buxhetit është rrit edhe ajo pjesa ku përfitojnë më së shumti qytetarët e Kosovës, ku taksat e taksapaguesve të Kosovës ju kthehen qytetarëve, që janë investimet kapitale dhe e shohim që investimet kapitale në fund të viti të kaluar pas shumë viteve e kanë mbërritur nivelin e 530 milionëve, derisa kjo nuk ka ndodhur në periudhat paraprake.

Ky është diagrami i investimeve kapitale.

Në vitin 2015 kemi 404 milionë, ndërsa në vitin 2018 i kemi 530 milionë. Nëse vazhdojmë tutje, edhe e shikojmë bilancin bankar nëpër vite, edhe pse kemi pasur një rritje të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike, ky është bilanci bankar. Nuk është përkeqësuar gjendja e bilancit bankar.

Derisa në fund të viti 2016 bilanci bankar ka qenë 271 milionë, në fund të vitit 2018 e kemi 388 milionë. Domethënë e kemi një përmirësim të bilancit bankar. Kemi një përmirësim të likuiditetit të shtetit.

Për të vazhduar tutje, sa i përket rezervës besoj që ishin sqarime. Unë nuk jam që t'i arsyetoj shpenzimin e parasë publike për asnjë centë jashtë rregullave. Jashtë procedurave. Jashtë transparencës, por edhe një sqarim; ka dallim i ndarjes buxhetore prej alokimit, zotimit dhe shpenzimit.

Nëse një organizate buxhetore u ka dhënë në dispozicion për shpenzim një ndarje buxhetore, i është bërë alokimi i asaj ndarjeje buxhetore, i është vendosur në dispozicion për shpenzim, nuk ka të drejtë ligjore t'i shpenzojë pa i respektuar të gjitha procedurat, dhe në fund pastaj e kemi edhe raportimin e atij shpenzimi.

Ne jemi të obliguar me ligj të bëjmë raportimin në baza periodike tremujore, në mbledhjen e radhës së Qeverisë sigurisht se do të diskutohet dhe pres që të aprovet edhe raporti vjetor për shpenzimin e buxheteve. Mirëpo, duke iu falënderuar edhe donatorëve, Kosova është i vetmi shtet në regjion, është në mesin e vendeve të rralla që e ka lansuar edhe portalin e transparencës, ku çdo para e shpenzuar nga çdo organizatë buxhetore bëhet publike.

Sa i përket ligjshmërisë të shpenzimit të parasë publike, janë edhe auditorët e brendshëm, është obligim edhe i Zyrës Kombëtare të Auditimit, edhe ata kanë obligim të bëjnë auditimin e

mënyrës së shpenzimit të parasë publike, a është në përputhje me ligjin, a është në përputhje me rregulloret dhe a është në përputhje e transparencën.

Përveç asaj, kurdo që ka dyshime të caktuara, organet për të cilat janë të paguara, për të cilat qytetarët e Kosovës paguajnë taksa, e kanë të drejtën e vet, ne s'mund t'i pengojmë, po duhet qenë bashkëpunues me ta që ta kryejnë punën e vet.

Sa u përket fondeve të fundit, për çka është thirrur edhe kjo seancë që është festimi i pavarësisë, janë ndarë me vendim të Qeverisë 500 mijë euro, presim që të kemi raport zyrtar prej organizatës buxhetore, e cila ka qenë e obliguar t'i kryejmë këto dhe të shohim se cili është niveli i shpenzimeve dhe për çka. Kur t'i marrim të dhënat zyrtare, në afat ligjor, por edhe kurdo që të kërkohet, nga kushdo që të kërkohet që kanë të drejtë, ne sigurisht që do t'i bëjmë transparente dhe e kemi obligim të njëjtat t'i publikojmë dhe t'i vendosim në dispozicion edhe të Kuvendit, edhe të publikut pa asnjë hezitim. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Qytetarë,

Janë dy tendenca pak a shumë që Qeveria po mundohet t'i paraqesë këtu bashkë me deputetët e shumicës.

E para është ajo që kolegu im Dritoni e tha më herët, përpjekjen që shpenzimet t'i mbulojnë me letra. Pra, të thonë që gjithçka ka qenë ligjore, po jo gjithçka ligjore mund të jetë e drejtë ose mund të jetë e logjikshme.

Dhe, e dyta, që bëhet një krahasim me shpenzimet e viteve paraprake dhe në këtë shumë totale të rumbullakohet edhe keqpërdorimi i sivjetmë, ka dy defekte në këtë drejtim.

E para, më i rëndësishmi, shuma totali e vitit 2017 ka përfshirë edhe procesin zgjedhor, pra 8 milionë euro kanë qenë të parapara me proces zgjedhor.



E dyta, vitin e kaluar, në vitin 2017, kanë qenë të parapara me rishikim mjetet, në vitin 2018 nuk ka pasur rishikim buxhetor dhe në qoftë se janë paraparë të shpenzohen 4 milionë euro, pse janë shpenzuar 8 milionë euro?

Deputetët e këtij Kuvendi kanë votuar për ato 4 milionë euro, i kanë ndarë, kanë dhënë votë në qartësi të plotë të ndarjes së parave. Shtimi në mënyrë arbitrare të këtyre mjeteve është i pashpjegueshëm, po është i pashpjegueshëm edhe stresi, edhe shqetësimi që partitë në pushtet e kanë sa herë që e trajtojnë këtë temë. Po unë s'po e kuptoj pse është ky stres. Pse duhet të kemi shqetësim, në qoftë se duam të flasim për shpenzimet e pavarësisë.

Kur themi ne që janë paguar 20-fish më tepër në parashuta se sa që janë faturuar, neve po na thuhet se po ndahet faktori shqiptar.

Pra, ne themi si është e mundur që keni faturuar një parashutë 12 mijë euro, 6 mijë euro për dizajnin, kur parashutat kanë qenë të dizajnuara. Deputetët e pozitës thonë po e ndani faktorin shqiptar me këtë temë.

Kur themi ne se është vjedhur në lapsa, se çmimi i lapsit që prezantohet është 30 cent, e jo 3 euro, neve po na thuhet, pse po merreni me këtë temë sepse s'shkakton kjo temë krizë financiare. Nuk shkakton krizë financiare vjedhja në lapsa, as shpenzimi i 500 mijë eurove s'shkakton krizë financiare.

Pra, për atë punë as shpenzimi i 53 milionë eurove për Bechtel&Enkën s'ka shkaktuar krizë financiare. Po shkaktoni krizë tjetër, krizën morale të shoqërisë, e i thonë kësaj krize korrupsion dhe kur Qeveria vjedh në lapsa në pavarësi, atëherë çka pret prej një kryesuesi të bordit atje që i punëson katër fëmijët e vet, është shembull, mënyra se si shteti funksionon.

Dhe kur ne themi hajde po e ndalim këtë praktikë të keqpërdorimit, sepse është e panatyrshme, është shumë e keqe dhe po thërrasim seancë të jashtëzakonshme, deputetët e pozitës, besoni ose jo, na tregojnë mesele, në atë thirrjen 'tërta vërta' apo si ishte, Blerim.

Pra, shikoni, ne e kemi një problem praktik, janë shpenzuar 500 mijë euro dhe tash kryeministri na tha që nuk janë 500 mijë, po janë 170 mijë. Unë po besoj që efekti i parë i debatit publik është arritur, sepse gjatë kësaj kohe Qeveria i paska zvogëluar shpenzimet, paska rënë nga 500 mijë në 170 mijë. Unë e kam një pyetje, çka ndodhi me vitin e kaluar, kryeministër? Ku shpenzimet e pavarësisë ishin 800 mijë euro, ishin 600 mijë të shpenzuara fillimisht, më pas u shtuan edhe 200 mijë.

Pra, si është e mundur që vitin e kaluar pavarësia të na kushtojë 800 mijë euro, e tash pas debatit publik ra nga 500 mijë në 170 mijë, unë po besoj që debati publik e ka arritur qëllimin e vet. Por, megjithatë shkeljet ligjore në këtë proces janë evidente dhe duhet të trajtohen.

Edhe për ministrin e Financave për ato tregues që i tregove, ministër, ne jemi duke fol për rezervën shtetërore. Në vitin e kaluar ne e kemi pasur një dëgjim publik, a është ashtu, në Komision për Buxhet dhe Financa, në të cilin ju keni thënë që për vendimet më të mëdha, dhe këtë e keni thënë publikisht të shpenzimit të rezervës shtetërore, ju nuk konsultoheni fare prej kryeministrit dhe fakti që ministri i Financave nuk konsultohet prej kryeministrit në shpenzimin e parasë publike për rezervë shtetërore, është treguesi i qartë i qasjes ad hoc që kjo qeveri e ka ndaj shpenzimit të parasë publike.

Për gjendjen ekonomike ju flasim qytetarëve tanë, ata po i shohin çdo ditë edhe punësimet në Postë, edhe humbjen e vendeve të punës, edhe migrimi, nuk besoj që grafet e përmirësojnë gjendjen reale ekonomike të qytetarëve tanë. Por, sot jemi mbledhur këtu të flasim për shpenzimin e rezervës shtetërore, për pak para në konceptin e krizës financiare, po për shumë domethënie për mënyrën se si kjo Qeveri udhëheq me vend dhe çfarë shembulli u jep qytetarëve të vetë.

Për fund, kryeministër, për 500 mijë euro 2 500 kosovarë do të punojnë 12 orë në dite dhe të shtunave, çdo vikend, për t'i paguar taksa këtij shteti. 2 500 kosovarë punojnë një vit për t'i bërë ato para, për t'i paguar tatimet ndaj Republikës së vet, unë besoj që këto para duhet shpenzuar me më shumë dinjitet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri Hamza, urdhëro!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Shumë shkurt,

Zoti Abdixhiku, është e vërtetë që Kuvendi i Republikës së Kosovës e aprovon Ligjin e buxhetit për ndarjen buxhetore. Në kuadër të kësaj janë edhe ndarja për rezervë, mirëpo pjesë e atij ligji është edhe një nen, që t'i e di, që në tremujorin e fundit i jep të drejtë Qeverisë që përmes vendimit të Qeverisë 5% të totalit të ndarjes buxhetore t'i lëvizë prej një ndarje në ndarje tjetër. Domethënë, sa i përket shumës është gjithçka në procedurë dhe në harmoni me ligjin.

Ndërsa sa i përket çështjes së shpenzimit të parave për pavarësinë, unë e përmenda që e kem momentin e ndarjes, të alokimit, zotimit dhe të shpenzimit, ne po flasim për ndarje prej 500 mijë eurove. Cili është shpenzimi, mbetet të shihet që sipas informatave preliminare, unë s'po flas zyrtare, kur t'i marr të dhënat, kur t'i marr faturat, sigurisht do të jem pjesë e raportit, flasim për një shumë tjetër, e cila është më e vogël se kjo çka po flitet.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra, deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë besoj se vetë mënyra se si po zhvillohet debati këtu dhe se si po jepen arsyetimet e tregon se sa e vështirë është gjendja dhe sa shumë ka keqpërdorime në menaxhimin e buxhetit dhe parasë publike.

Pra, asnjë rast këtu nuk po flitet se a kanë qenë vendimet të drejta, a kanë qenë vendimet e duhura, a po shpenzohen mjetet e rezervave për rastet që janë vërtet të paparashikuara dhe për interes të qytetarëve, por po flitet vetëm për anën procedurale. Pra, a është shkelur ligji, a është marrë parasysh baza ligjore, a kemi pasur të drejtë të marrim një vendim proceduralisht, formalisht, paçka se ky vendim nuk ka qenë as i drejtë e as i duhur.

Për më tepër, meqenëse këtu u përmend baza ligjore, unë dua të përmend për qytetarët se për çfarë baze ligjore po flasim, sepse edhe baza ligjore nuk i arsyeton këto vendime të Qeverisë, po edhe të qeverive të kaluara, sepse u fol se historikisht ka ndodhur e njëjta gjë, që është po aq shqetësuese.

Në vend se ne kur të identifikojmë se cilat janë gabimet ose se si nuk është menaxhuar mirë buxheti dhe të përmirësojmë atë situatë, ne vazhdojmë me të njëjtën mënyrë, duke u arsyetuar, gjegjësisht kjo Qeveri vazhdon me të njëjtën mënyrë duke u arsyetuar me faktin se edhe qeveritë e kaluara kanë vepruar në të njëjtin mënyrë.

Dhe, unë po e përmend për qytetarin bazën ligjore, të cilave u referohen vendimet, duke filluar prej Kushtetutës, gjegjësisht nenit 92, paragrafi 4 dhe nenit 93, paragrafi 4, po ashtu, të cilat, në fakt, thotë, po e citoj: “Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentim të ligjeve ekzistuese”, pra ka të bëjë me të drejtën e Qeverisë për të marrë vendime, gjegjësisht për të propozuar ligje apo amendamente të tilla dhe njëjtë është edhe neni 93, paragrafi 4, ku prapë thotë: “Qeveria merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore”, por kjo në asnjë moment nuk do të thotë se vendimet duhet të jenë krejtësisht arbitrare dhe duhet të jenë në interes të grupeve ose interesave krejtësisht të caktuara, për rastet të cilat do të mund të ishin parashikuar.

Dhe, po ashtu i referohet edhe ligjit, gjegjësisht nenit 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, ku parashihen kushtet për ndarjen e këtyre mjeteve. Pra, përmendet, po e citoj nga ligji: “Nëse ndodh një rast për të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara” dhe se duhet të shpjegohen arsyet se pse këto rrethana nuk mund të parashikohen.

Dhe, unë besoj që edhe ministri i Financave, edhe kryeministri, edhe të tjerët këtu nuk mund të mohojnë faktin se shpenzimet për shënimin e përvjetorit të pavarësisë ose shpenzime të ngjashme, çfarë janë ndërmarrë këtu, nuk janë shpenzime që nuk kanë mundur të mos parashikohen ose nuk janë shpenzime për nevoja urgjente.

U përmend nga zoti Haradinaj edhe rastet se edhe në të kaluarën janë marrë vendime për mbështetje për persona, individ të caktuar, të cilët kanë pasur nevojë për trajtime më të kushtueshme apo jashtë vendit.

Pajtohem se është e nevojshme dhe shumë mirë dhe është obligim i institucioneve dhe i shtetit t'u ndihmojë qytetarëve të tyre, në rastet kur ata nuk mund të sigurojnë kujdesin shëndetësor të duhur. Por është për t'u ardhur keq se vendimet gjithmonë mbështesin politikanë apo persona të cilët kanë ndikim, e të cilët nuk janë financiarisht në gjendje të keqe, derisa secili prej nesh për çdo ditë shohim raste, madje edhe fëmijëve, të cilët mundohen të gjejnë forma për të siguruar mjete për shërimin e shokëve të tyre.

Pra, Qeveria nuk kujdeset të marrë vendime që të përmirësojë gjendjen në sistemin shëndetësor kudo nëpër Republikën e Kosovës, në spitale dhe në ambulanca, ku do të përfitonin të gjithë qytetarët e vendit, po favorizon me shuma të mëdha persona të caktuar për shkak të ndikimit të tyre që kanë politik, edhe kur ata nuk kanë nevojë për mbështetje të tilla.

Për më tepër, duhet përmendur këtu edhe një vendim të datës 29 janar 2018, me të cilin vendim autorizohet ministri i Financave që të aprovojë transferin nga nënprogrami shpenzimet e paparashikuara në një nënprogram tjetër, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40 mijë eurove.

Pra, me vendim të ministrit, mund të bëhet transferimi deri në 40 mijë euro për persona për raste të caktuara.

Dhe, fatkeqësisht, kemi pasur raste që edhe këtu domethënë ka pasur raste të përkrahjes, përkatësisht subvencionimit të institucioneve, të cilat as nuk kanë pasur nevojë për përkrahje të tilla. Po përmend vetëm një rast të përkrahjes apo të mbështetjes të një institucioni edukativo-arsimor privat, i cili i ka kushtet shumë të mira dhe ku vijnë mësimin fëmijët e prindërve me vetëfinancim, derisa të gjithë jemi dëshmitarë që në shkollat publike mungojnë kushtet elementare për krijimin e mësimin të mirëfilltë shkencor, kabinetet, laboratorët, apo edhe për mjetet elementare për punë, e të mos flasim këtu për përfshirjen në edukimin parafillor, ku gjendja është jashtëzakonisht e vështirë.

Pra, ajo që duhet të kihet parasysh është se edhe nëse po respektohet aspekti formal, pra se Kushtetuta e parasheh se Qeveria e vendit duhet të marrë vendime dhe mund të marrë vendime,

çështja këtu është se vendimet që po merren nga Qeveria nuk janë vendime të drejta dhe, për më tepër, edhe në aspektin ligjor bie ndesh, sepse vendimet kanë të bëjnë me rastet, të cilat do të mund të ishin të planifikuara, do të duhej të ishin të parashikuara dhe nuk shpjegohen arsyet se pse këto rrethana nuk janë parashikuar në vendimet, të cilat janë marrë. Pra, nga 60 vendime që janë marrë vetëm vitin e fundit për përkrahje me shuma të caktuara nga Fondi i Rezervave, që janë vendime të llojllojshme, përfshirë këtu, disa i përmendi Glauku, por edhe shumë vendime të tjera, të cilat fare mirë do të mund të ishin parashikuar, bie në sy se të gjitha këto vendime, janë vendime, të cilat të përbashkët e kanë vetëm faktin se mbi 80% e tyre kanë qenë vendime që do të mund të ishin parashikuar. Pra, derisa kemi raste, unë kam këtu një vendim që është i drejtë sigurisht vendimin e datës 4. 5. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në një shumë prej 20 mijë euro për mbështetjen e familjarëve të zyrtarëve policorë që kanë humbur jetën tragjikisht, që është vendim i drejtë, se është diçka që nuk ka mundur të parashihet dhe Qeveria është dashur të japë mbështetje për raste të tilla, kemi me të njëjtën bazë ligjore, me të njëjtën mënyrë ndarjen e mjeteve, për shembull, për shënimin e Pavarësisë ose aprovimi i kërkesës së koordinatorit nacional për Kulturë, Rini dhe Sporte, nuk i shënohet emri, por mirë përmendet se bëhet fjalë për zotin Rexhep Hoti, i cili është koordinator nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, në shumën prej 200 mijë eurove.

Kur keni emëruar zotin Hoti koordinator nacional për Rini dhe Sport, ju është dashur të parashihni edhe punën, detyrat dhe përgjegjësitë e tij dhe njëkohësisht të ndani edhe buxhetin për realizimin e këtyre aktiviteteve, gjë që duket nuk se nuk e keni bërë, sepse i ndani mjetet nga rezervat për të realizuar një projekt, i cili po bëhet me shumë nxitim dhe i cili ka shqetësuar goxha shumë shkollat, sepse është marrë një vendim për organizimin e një projekti në mënyrë shumë të shpejtë, pa i konsultuar shkollat, duke shtuar përgjegjësi shtesë dhe i cili i ka të gjitha predispozitat që të mos jetë i suksesshëm. Pra, vendimet për ndarjen e këtyre mjeteve financiare nga Fondi Rezervë janë të natyrave të llojllojshme, që nga organizimi i mbledhjeve, nuk u përmend, janë dhënë mbi 120 mijë euro për organizimin e mbledhjes në mes të dy qeverive, organizimi i pushimeve verore, i shënimit të përvjetorëve, ndarjes së mjeteve për shërim jashtë vendit për persona të caktuar, të cilët nuk kanë edhe aq nevojë për mbështetje të tillë financiare, për pagesë të borxhit e për çfarë jo dhe në asnjë rast nuk është përfillur, pra, kriteri ligjor sipas nenit 29, të cilit i referohet vetë preambula e vendimeve të Ligjit për menaxhimin e financave publike, i cili parasheh se këto duhet të jenë raste të paparashikuara dhe të cilat nuk do të mund të ishin parashikuar më herët.

Kjo mënyrë e menaxhimit të parasë publike nga ana e Qeverisë së Kosovës sigurisht se është e papranueshme, është shumë shqetësuese që të shihet një praktikë e tillë e shpërdorimit të buxhetit publik dhe parave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët për çdo ditë ballafaqohen me vështirësi të jashtëzakonshme edhe për të siguruar jetën e tyre minimale dhe arsyetimi i vetëm të jetë se kjo gjë ka ndodhur edhe përpara, kështu që nuk keni të drejtë tashmë

të ankoheni, sepse edhe qeverisjet e kaluara kanë shpenzuar buxhetin në të njëjtën mënyrë, duke marrë vendime shumë shpesh në mënyrë të njëanshme.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Nagavci! Fjalën e ka kryeministri, zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pra, edhe një herë më falni, po për sqarim po ju them, sa u përket shpenzimeve për Pavarësinë, pra për përvjetorin e Pavarësisë, procedura ju tregova si është, domethënë jep një propozim, merret një vendim, i alokohen një institucioni edhe këto janë procedura që nuk i kemi krijuar sot, pra ekzistojnë, janë ligjore, i dini si shkojnë. Pastaj, te shpenzimi, mënyra si janë shpenzuar, ato që janë shpenzuar, si ju thashë, unë po e shoh që ju po i konkludoni vetë gjërat ende pa marrë ndoshta një raport a një informatë, ndoshta është dashur edhe ju të pritni ta keni një informatë të saktë, se veç me tituj të gazetave, ndoshta edhe ju në ato që po besoni, mund të mos jenë ashtu, ose me tituj të lajmeve.

Pra, unë ju thashë që kam kërkuar një auditim të brendshëm, edhe atë ende pa tituj, as pa kurrëgjë, për hir të saktësisë së brendshme, për shkak se është respekti për një situatë të tillë, edhe ju siguroj që nëse një cent, s'po di, një shpenzim është bërë jashtë ligjit ose kundër ligjit, atëherë ajo punë është për prokurorinë dhe ne e mirëpresim atë dhe nuk e amnistojmë askënd, bash kurrëkënd. Sa i përket marrjes së vendimit, si merren këto vendime, ju siguroj që nuk ka ndonjë zhvillim të ri, pra janë proceseve, vendime që i dini si shkojnë, pra janë dy momente: një është marrja e vendimit dhe dy është shpenzimi në vete, si ka ndodhur. Por, nëse ka shkelje të ligjit, aty duhet të kyçet prokuroria, le të shkojë në burg ai që e ka bërë.

Pse po e them kështu në kuptimin që qëllimi i Qeverisë as i prezantimit në asnjë variant nuk është të mbrojë çfarëdo keqpërdorimi potencial nëse ka.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zeka.

MILAIM ZEKA: Së pari desha t'i drejtohem kryeministrit edhe t'i kallëzoj që qysh ka rënë një grip shumë i rëndë në Kosovë, që është dashur të thirret një seancë e jashtëzakonshme për gripin, seriozisht e kam, që ministri i Shëndetësisë nuk ka dalë me asnjë deklaratë, as kurrkush nuk po shqetësohet dhe, për fatin e zi, janë bërë budalla edhe mediat, sikur ne deputetët, sikur ministrat, nuk sheh askund lajme për këtë fenomen shqetësues. Mediat në Shqipëri kanë folur për gripin, për një sëmundje shumë të rëndë, i lëshon lajmet në televizionet tona, askund kronikë të gripit s'ka.

E lëmë atë, desha t'i drejtohem kryeministrit edhe t'i them që po i sillen do hajna të vegjël rreth e rreth që po i vjedhin me lapsa, me flamuj të pavarësisë, po i vjedhin me dekorimin e 4 shtyllave që është bërë në qendër, e që kanë shkruar se kanë kushtuar nga 12 mijë euro. Në qoftë se kryeministri nuk i eliminon këta hajdutë të vegjël, imagjino pastaj ata hajnat e mëdhenj çka vjedhin, por imagjinoni dhe ju deputetë të nderuar, se edhe Ditët e mërgatës kur kanë qenë, merrini dhe shikoni kapelat shkruan Made in China, i kanë prodhuar kapelat në Kinë e ua kanë dhënë mërgimtarëve. Dhe, këtë nuk e kam zbuluar unë, por vajza ime, e ktheu kapelën, 11 vjet vajza, “shih, babë, tha, në Kinë i paskan prodhuar e i kanë pru po na i japin neve”.

Tani do të kaloj te dy deputetë që s'qenkan në sallë këtu, por s'po ua përmend emrin, Dritonit dhe Lumirit. Më duket që këta dy deputetë po i hajn 'foret' e disa njerëzve, për arsye se e kanë thirrur një seancë të jashtëzakonshme pa kurrfarë nevojë. Alokimi i mjeteve të Qeverisë është bërë në mënyrë ligjore, por ne duhet të kërkojmë në qoftë se me këto mjete janë bërë keqpërdorime. Por, kur jemi te fjala e keqpërdorimeve, atëherë unë dëshiroj të them se disa herë Lumiri e përmendi, tha që Qeveria po mbulohet mirë me letra. Qeveria po mbulohet mirë me letra, sepse ka marrë mësim nga Riinvesti, i cili nuk është mbuluar fare mirë me letra në kohën e Agim Çekut, kur i kanë vjedhur 1,8 milion euro Riinvesti së bashku me Agim Çekun. Para, Riinvesti e di Lumiri kush është, e di Lumiri, e dinë disa njerëz këtu që kanë qenë pjesë të Riinvestit. Domethënë, 1,8 milion euro janë vjedhur para të DIFID-it anglez edhe para të SIDA-s suedeze për Planin strategjik zhvillimor të Kosovës. Kanë ardhur “ekspertët” nga Anglia, pa qenë asnjë ditë në Kosovë kanë marrë mëditje 700 euro, mëditje domethënë për një ditë janë paguar 700 euro. Këto janë bërë krejt në kohën kur ka qenë kryeministër Agim Çeku dhe, në qoftë se unë po rrej, atëherë qe sa mirë erdhi, zëvendësministër atëherë ka qenë i Ekonomisë edhe Financave, ish- shoku im i klasës, tash që është ministër i Financave, Bedri Hamza, le të dalë në foltore dhe le të thotë a po e them të vërtetën a jam duke gënjyer? Sepse, në atë kohë ka qenë zëvendësministër, por Ahmet Shala nuk e lejonte këtë të vjedhë, se ka qenë njëfarë rendi aty, vidhnin të tjerët, por unë e konsideroj nga ministrat më të ndershëm edhe këtë, edhe profesorin Avdullah Hoti. Por, nganjëherë të dytë i kanë mbyllur sytë para hajnive, kanë ditur që po vidhet, po tash unë të tregoj, prof. ku i ke mbyllur sytë, avash-avash, krejt i kam këtu dokumentet.

Plus, zoti kryesues, e kam edhe minutazhin e 6+, edhe të tjerëve, se dua të flas pak me fakte.

E përmend shpesh Skënderbeun, viti i Skënderbeut, të lutem Driton, edhe Lumir, edhe të tjerëve hyni edhe gjeni dosjen sa ka kushtuar monumenti i Skënderbeut kur ka ardhur në Prishtinë. Shikojeni sa para janë vjedhur në monumentin e Skënderbeut kur ka ardhur në Prishtinë. Është shkruar fatura mbi 800 mijë euro dhe për këtë nuk është bërë asnjëherë debat. Nuk është bërë asnjëherë debat për hajninë, thashë, që është bërë 1.8 milion euro në kohën e Agim Çekut për Planin strategjik zhvillimor. Tjetra, kisha pasur dëshirë që, Driton, në pjesën tënde të fjalimit the “nuk po i shoh partitë opozitare” a the kështu? Ne ishim në sallë, disa herë po e përmend këtë,

unë s'jam në opozitë, s'jam me juve, unë jam me juve kur keni të drejtë, por këtë seancë ka mundur eventualisht për keqpërdorime, eventualisht ka mundur të thërrasë seancë Vetëvendosja ose Partia Socialdemokrate, po seancë për keqpërdorime të thërrasë LDK-ja dhe PDK-ja, është jashtë çdo logjike, sepse bashkë keni qenë edhe në qeverisje, edhe në keqpërdorime, edhe në të gjitha. Prandaj, po them që nuk është e ndershme sa herë flisni të thoni, që valla, nuk janë këtu pozita, ne këtu jemi. Ju kam thënë edhe një herë, kur keni për seanca të jashtëzakonshme dhe që kanë logjikë brenda vetes, na i sillni se edhe unë i nënshkruaj ato edhe ka plot deputetë të pozitës që i nënshkruajnë këto seanca.

Sa i përket punës së filmave, nuk dua të hyj andej, sepse e dini ju më mirë si ka shkuar çështja e shumë filmave edhe në kohën kur ju keni qenë në pushtet. Po tash, dua të them, të nderuar deputetë, e sidomos ju qytetarë të nderuar, do të flas për shpenzimet shokante që i ka bërë Qeveria e Isa Mustafës, së bashku me qeveritë e PDK-së në Bruksel. I kam nxjerrë të gjitha të detajuara shpenzimet që i ka bërë vetëm një person, vetëm Edita Tahiri dhe imagjinoni kur vetëm ajo i ka bërë këto gjithë shpenzime, çka kanë bërë ata hajnat e mëdhenj që i thashë kryeministrit. Domethënë, kur këta vjedhin lapsa, çka bëjnë këta që vjedhin me traktorë. E kam thënë në këtë foltore, një traktor është shitur tri herë nga 60 mijë euro, 180 mijë euro është shitur një traktor në emrin e granteve për bujqësi. Po ia filloj me vitin 2011. Shpenzime të akomodimit, 17 822 euro. Mëditje, 8 613 euro. Shpenzime të reprezentacionit, 2 385 euro. Bileta të avionit, 9385 euro. Shpenzime të tjera, 1 443 euro. Gjithsej shpenzime për Edita Tahirin 39 650 euro, ndërsa shpenzime për ekipin e Edita Tahirit vazhdojnë. Shpenzimet e akomodimit 69 629 euro. Mëditje, 50 765 euro. Shpenzime të reprezentacionit, 7 431 euro. Bileta, 56 446 euro. Shpenzime të tjera, 13 154 euro. Shpenzime të telefonit, 2 400 euro. Pagesa të ekspertëve, merreni me mend, 10 mijë euro. Gjithsej kabineti i Edita Tahirit vetëm për 2011-tën i ka shpenzuar 209 827 euro.

Kalojmë tash te viti 2012. Shpenzimet e akomodimit, 24 767. Mëditje, 16 413. Shpenzime të reprezentacionit, 9 550. Biletat, 13 506. Gjithsej 65 182 euro vetëm për Edita Tahirin. Ndërsa për ekipin e saj në total, 273 769 euro.

Kalojmë te shpenzimet e vitit 2013. Shpenzime të udhëtimit dhe bileta, 260 597 euro. Po i bie shkurt, d.m.th. 2013-ta, a e di sa e mbërrin totalin, 417 130 euro.

**KRYESUESI:** Faleminderit zoti Zeka! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj. Duhet ta dini një gjë. Edita Tahiri ka qenë përfaqësuese e Kosovës dhe e ka përfaqësuar, jo, jo, mund ta thërrasësh në Komision, të formosh komision ta vërtetosh çka ka, edhe debatojmë edhe në Kuvend, thirre debatin, po ne s'kemi thirrur debat për Edita Tahirin, të lutem ulu në vend!

Fjalën e ka zoti Zemaj.



ARMEND ZEMAJ: Faleminderit kryesues!

Kolegë deputetë,

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, te termi paratë publike nënkuptojnë paratë ose pasuritë financiare që pranohen dhe janë nën përkujdesjen e një autoriteti publik. Ky autoritet jeni ju z. kryeministër, zoti ministër i Financave dhe ju si autoritet nuk po përkujdeseni për shpërndarje në interes të zhvillimit të vendit, por po i lejoni edhe keqpërdorime qofshin ato edhe të imëta.

Është e vërtetë që vendimet e Qeverisë janë publike edhe ato sipas ligjeve në fuqi, por problemi është në dy aspekte të tjera. E para, shpërndarja e cila bëhet në mënyrë klienteliste dhe në interes të mbulimit të nevojave të pushtetit, qoftë me kushtëzime dhe qoftë me interferime të tjera. E dyta, është shndërruar edhe në strategji të këtij pushteti që sa herë tentohet të flitet për keqpërdorimet e taksave të qytetarëve, të mundohen të mbulojnë zhvatjen dhe vjedhjet buxhetore, duke u thirrur edhe në data historike, ngjarje të veçanta dhe tema të rëndësishme, apo të mëdha që janë aktuale në vendin tonë. Të keqpërdorësh buxhetin në ditën e përkujtimit, ajo që është ditë historike e pavarësisë është më shumë sesa vjedhje, është marri dhe është ofendim për të gjithë qytetarët e Kosovës edhe miqve tanë që e kanë mbështetur lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Këtë nuk e besoj që e kanë bërë krerët qeveritarë. Është e vërtetë që e kanë bërë ata që janë rreth tyre dhe që merren me punë të imëta e të pista, sepse Qeveria merret me punë të mëdha, me milionat e Bechtel-Enka-s, me falje 50 milionë të borxheve e shuma të tjera marramendëse, andaj edhe kjo e ka logjikën e vet.

Kolegë deputetë,

Shikoni vendimet e shpërndarjes së buxhetit të vitit 2018, vetëm disa që janë nga shpenzimet e paparashikuara.

Buxheti i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete sillet diku rreth 8 milionë euro dhe asnjëherë në mbikëqyrjen e Auditorit të Përgjithshëm këto shpenzime nuk kanë dalë në mënyrë efikase. Por, paramendojeni kur Qeveria përkundër lejimit të këtij shpenzimi të këtij buxheti në mënyrë jo të drejtë, ndaj edhe miliona edhe nga fondi i shpenzimeve të paparashikuara. 50 mijë euro për Këshillin Konsultativ për Komunitete në kuadër të Zyrës së Presidentit. 40 mijë euro për realizimin e aktiviteteve për afirmimin dhe integrimin e komunitetit malazez në Kosovë, dy herë brenda vitit 2018 nga 40 mijë euro. 40 mijë euro për komunitetin kroat që jeton në Janjevë. Një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimit të furnizimit me energji elektrike të katër komunave veriore të Kosovës, edhe pse qytetarët e Kosovës paguajnë dhe i mbulojnë edhe ato shpenzime. 285 mijë euro për pagesën e qirasë për Kishën Ortodokse Serbe, 20 mijë euro për zonjën Flutura Ibrahim, asnjë arsytim. 120 mijë euro për 800 familje të rrezikuara të komunitetit egjiptian, asnjë arsytim.

Prapë 120 mijë euro për 1348 familje të rrezikuara të komunitetit egjiptian, asnjë arsytim. 50 mijë euro prapë për Këshillin Konsultativ për Komunitete. E shumë e shumë vendime të tjera që e kanë logjikën e njëjtë.

Kolegë deputetë,

Ne sot edhe mundemi fare të mos debatojmë, të thërrasim Prokurorinë e Shtetit që të hetojë këto raste, por është jashtë çdo logjike që Kuvendi të anashkalohet nga debati parlamentar për të nxjerrë në pah mbikëqyrjen parlamentare rreth shpenzimeve të parasë publike. Dhe një përgjigje për disa kolegë, dy djem të rinj nga ana e Rekës së Keqe i shtin fjalët diçka dhe njëri e nervozon e ia krisi shuplakë tjetrit. Ai tjetri ia kthen shpullë në birë të veshit. Dikur kur e panë se hyn thellë, njëri po ia bën tjetrit: a e lamë burrë këtë punë për hajgare. Këto punë nuk lihen për hajgare. Hajnia nuk lihet dhe zhvatja e buxhetit për hajgare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Cili e doni? Zoti Haradinaj e ka fjalën, Dauti.

DAUT HARADINAJ: Merr frymë, merr frymë Albulenë një sekondë se veç një minutë. Unë e kërkoja fjalën për replikë ndaj Milaim Zekës dhe nuk do të zgjatem shumë për debatin.

Në që unë e kam një respekt të jashtëzakonshëm për Milaimin dhe vlerat e tij, por nuk pajtohem kur p.sh. i thotë një ish-kryeministri i cili kurrë nuk është akuzuar ose hetuar ose paditur për asnjë vepër penale, që nënkupton vjedhje e asaj shume. Nuk mund t'i themi Agim Çekut hajn bashkë me hajna të tjerë, sepse të paktën nxirri provat thuaj që këtë e kanë nxjerrë, edhe ta qojmë direkt në prokurori.

E dyta, nuk po e mbroj Edita Tahirin se kurrë s'jam pajtuar as me përfaqësimin e saj në ekipin negociator, as s'pajtohem me vendimet ose marrëveshjet që i ka realizuar, por ajo ka qenë përfaqësuese e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në dialog. Dhe njëjtë nesër ose pasnesër, ose pas një viti do ta kemi një raport të delegacionit shtetëror, i cili ka bërë shpenzime në bileta në akomodim. Unë e di që ata nuk mund të flenë në stacione të trenit, se është delegacion shtetëror. Pra, kur kemi fakte, kur kemi prova, le t'i adresojmë ku duhet.

Sa i përket shpenzimit të mjeteve në rastin e pavarësisë së Kosovës, ose 500-vjetorit të Gjergj Kastriotit, kushdo që ka dilema duhet t'i bëjmë thirrje hetuesisë, prokurorisë t'i hetojë, t'i nxjerrë para drejtësisë, të gjithë ata të cilët kanë bërë abuzim me paranë publike. Por sot nuk kemi asnjë raport me shkrim sesi janë shpenzuar, çfarë shtate jemi, dhe derisa ne nuk kemi, debatojmë kot.

Gjithmonë Parlamenti e ka obligative edhe me Rregullore, edhe me të gjitha, edhe me Kushtetutë, që do ta ketë nën mbikëqyrje Qeverinë dhe Ministrinë rreth shpenzimeve. çdo diskutim, çdo debat është i mirëseardhur, po jo me fyerje, jo me shpifje, jo me akuza të pabaza, siç po i dëgjojmë disa kolegë këtu, edhe duke na kallëzuar batuta, pallavra të Rekës së Keqe.

Faleminderit, replikë, kundër-replikë kanë Milaim Zeka dhe Armend Zemaj.

MILAIM ZEKA: E para, mund të ketë ndodhur një keqkuptim, nuk thash hajn Agim Çeku, po thash RIINVEST-i ka vjedhur, paratë 1,8 milion euro. Për atë e kam dosjen 2500 faqe edhe kur të duan i kam bërë thirrje Prokurorisë edhe ua ofroj kur të duan Prokuroria.

E dyta, sa i përket Edita Tahirit, vetëm desha ta potencoj se ka qenë Qeveria e Isa Mustafës që ka alokuar mjete marramendëse për dialogun e Brukselit. Tani, në qoftë se ka parregullsi, është prapë punë e Prokurorisë. Dhe krejt këtë desha të bëjë si krahasim që seanca e sotme është thirrur komplet pa lidhje, sepse procedurat kanë qenë në rregull. Në qoftë se firma e cila i ka shpenzuar këto para për pavarësinë në mënyrë të parregullt, është çështje e Prokurorisë. Veç sa për sqarim.

KRYESUESI: Zoti Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Kolegë deputetë,

Unë po e përsëris atë që e theksova që sa herë që flasim për zhvatje të buxhetit, shpeshherë edhe për krim të organizuar, korrupsion, aktivitete kriminale, dikujt i vjen nxehtë, edhe tmerrohet nga ngritja e këtyre temave, andaj është mirë që tema për të cilën po debatojmë, është temë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, u takon deputetëve që të përkujdesen për mbikëqyrjen parlamentare të shpenzimit të parasë publike dhe kjo është detyrë e jona edhe kushtetuese edhe ligjore. Çdokush që mundohet të interferojë apo të interpretojë në mënyrë tjetër, është e padrejtë, është e papranueshme edhe e pandershme.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën. Replikë? Më fal, zoti Haradinaj ka replikë.

DAUT HARADINAJ: Unë e thashë atë që e dëgjova në foltore. Kjo vlen për Milaimin. Unë bëra thirrje që të diskutohet për çka jemi thirrur, edhe unë jam shumë dakord, edhe kushdo që ka bërë ndonjë shkelje ligjore të dalë para drejtësisë. Këtij emnakut afër këtu që e kam, nëse mua po më vjen nxehtë, këtij shpresoj që i vjen fllad.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, është komplet e papranueshme sesi deputetët e këtij koalicioni të pakicës e kundërshtojnë thirrjen e kësaj seance duke u arsyetuar se kjo nuk është e jashtëzakonshme dhe sesi Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk po bëka të diskutojë për shpenzimet marramendëse të Qeverisë. Në fakt, kjo është puna jonë kryesore dhe ky Kuvend në fakt është thirrur shumë shpesh në seanca të jashtëzakonshme për çështjen e dialogut. Pse duhet të jetë dialogu me Serbinë çështje më e rëndësishme sesa shpenzimi i parasë publike dhe kur kihet parasysh që

Kosova ka jashtëzakonisht shumë probleme. 40 për qind e popullsisë janë të papunë, ka varfëri ekstreme dhe natyrisht që shpenzimi i parasë publike në këtë mënyrë është një thirrje që duhet të na bëhet të gjithë deputetëve, pra pikërisht për ta thirrur seancën e jashtëzakonshme dhe për të diskutuar për këtë çështje, prandaj ata që flasin sesi nuk po bëka deputetët të thërrasin seanca të jashtëzakonshme për këtë çështje, kanë një tendencë që ta zbehin gjithë këtë çfarë ka ndodhur gjatë kësaj kohe, sidomos nga janari, por Qeveria Haradinaj duhet pasur parasysh që keqpërdorimet e buxhetit i ka bërë qysh kur e ka marrë timonin e kësaj Qeverie. Është vendimi p.sh. për rritjen e pagave për vete.

Dhe pikërisht është ky vendim i Qeverisë Haradinaj i datës 26. 2. 2019 për të cilin do të flas edhe në këtë seancë. Po i referohem një vendimi për shtesat e prokurorëve specialë. Pra, që është marrë më 26. 2. 2019. Pra, ky vendim ka të bëjë me mjetet ose ndarjen e mjeteve për kompensim shtesash dhe stimulim për vitin 2019 për Prokurorinë Speciale në vlerë prej 171 mijë euro, 171 mijë e 862 euro.

Ky vendim në fakt është një tendencë që t'i mbyllet goja Prokurorisë Speciale. Pse po e them këtë? Ne si Vetëvendosje para një viti kemi bërë kallëzim penal kundrejt Qeverisë Haradinaj për ngritjen e pagave. Pra, për vendimin e paligjshëm për ngritjen e pagës për vete.

Pas atij kallëzimi penal e gjithë Qeveria Haradinaj është në hetim nga Prokuroria Speciale, sepse neve na kanë thënë që Prokuroria Speciale është duke u marrë me vendimin e paligjshëm për rritjen e pagës për vete. Pra, sipas kompetencës, ky kallëzim penal i ka shkuar Prokurorisë Speciale.

Duke qenë që Qeveria Haradinaj është në hetim, ky vendim për shtesa dhe stimulim, në fakt nuk është për t'i stimuluar prokurorët specialë, por është që të heshtin ata karshi hetimeve që po bën prokurori special ndaj Qeverisë Haradinaj.

Ta zëmë shtrohet pyetja; pse nuk u dhanë shtesa për gjyqtarët e departamentit për Krime të Rënda? Pse nuk u dhanë për ata? Pse u dhanë bash për prokurorët special që po merren me hetimin e vendimit të paligjshëm për rritjen e pagave që është vendimi kundërligjshëm. Është shkelje. Është vepër penale.

Pra, kur do ta kuptoni si Qeveri që në një vend ku pushtetet janë ndara qeveria nuk guxon ta marrë asnjë vendim që ka të bëjë me të ardhurat e prokurorëve dhe gjyqtarëve, sepse kjo është ndërhyrje në punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë.

Në qoftë se duhet t'i ndajmë mjete shtesë sistemit të drejtësisë, atëherë këto mjete duhet të ndahen për shërbyesit civil të cilët janë në kuadër të sistemit të drejtësisë, sepse pas vendimit për

rritjen e pagave që i ka prekur edhe prokurorët dhe gjyqtarët, ata janë me paga jashtëzakonisht të vogla, 250, 300 e 400 euro.

Çfarë vullneti kanë shërbyesit civil në sistemin e drejtësisë? Pra, me këto vendime po bëni edhe diskriminime. Dhe natyrisht që tendenca e vetme është që Prokurorisë Speciale t'ia mbyllini gojën. Ashtu-kështu që një vit, prej që e kemi dërguar kallëzimin penal nuk kanë ndërmarrë veprime, përveç se na kanë thënë jemi duke u marrë hetimet për sa i përket kësaj çështjeje.

Çfarëdo vendimi për shtesa ose për të ardhurat e prokurorëve dhe gjyqtarëve i takon Kuvendit të Kosovës. Pra, Kuvendi i Kosovës është autoriteti i vetëm që e ka këtë kompetencë.

Më tej, fatkeqësisht, në mars të vitit të kaluar kaloi marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi, dhe Qeveria Haradinaj deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim edhe përkundër premtimeve publike për adresim të kësaj çështjeje.

Pra, në vend të rishqyrtohej marrëveshja që i fal mbi 8 mijë e 200 hektarë Malit të Zi, që është nënshkruar nga Hashim Thaçi, Kuvendi votoi marrëveshjen që fal territor. Pra, përveç e humbëm territorin, tash po e humbin edhe buxhetin. Pse? Sepse edhe në 2018-tën, Qeveria i ka ndarë 152 mijë euro. Në 2019-tën, 115 mijë euro.

Pra, përveç që e humbëm territorin tash po vazhdojmë që ta humbim buxhetin. Kur kishim mundur edhe ta ruajmë territorin, duke e refuzuar atë marrëveshje, por edhe duke e kursyer buxhetin e shtetit.

Në fakt ajo çfarë kemi parë nga qeveritë e pasluftës dhe nuk është rastësishme që thuhet që kanë vjedhur edhe në përmendore, edhe në shënime përvjetorësh. Nuk është e rastësishme, kështu ka ndodhur në fakt.

Sa i përket shpenzime për 11-vjetorin e pavarësisë, janë ngritur dyshime me të drejtë, dhe për mua janë të papranueshme deklarata e kryeministrit Haradinaj duke u mundur që t'ia hedhë fajin dikujt tjetër, del e thotë; e po në Qeveri janë shumë shërbyes, aty ka edhe PDK edhe LDK, pra fajin dhe përgjegjësinë që e ka ai, ministri i Financave dhe ministri i Kulturës sa i përket buxhetit apo shpenzimeve marramendëse për shënimin e 11-vjeorit të pavarësisë, tenton t'ua hedhë disa zyrtarëve.

Tash, çka ka ndodhur? Ne menjëherë pas publikimeve që janë bërë në media kemi kërkuar qasje në dokumente publike. Edhe sipas Kushtetutës, sepse sipas Kushtetutës edhe qytetarët, përfshirë edhe ne si deputetë, kemi të drejtë të qasemi në dokumente publike. Ato nuk janë sekrete.

Duke qenë që ka kaluar më shumë se dy javë prej kur kemi dërguar kërkesë për qasje në dokumente pikërisht për këtë çështje, ende nuk e kemi marrë asnjë informacion, asnjë përgjigje nga Qeveria sa i përket kësaj, sepse ne i kemi kërkuar shpenzimet me fatura. Të gjitha. Ku janë shpenzuar ato. Nuk i keni sjellë. Shtatë ditë i keni pasur në dispozicion.

Kështu ka ndodhur edhe me marrëveshjet e deritanishme të nënshkruar me Republikën e Shqipërisë. Për shembull e përmendi edhe zonja Nagavci, në takimin e përbashkët që e keni pasur, janë shpenzuar 120 mijë euro. Për çka more? Për një takim që e keni mbajtur në Pejë 120 mijë euro. Çka keni bërë me ato 120 mijë euro?

Dhe kur jam këtu, njësoj është çështja. Ne kemi kërkuar qasje në dokumente publike për marrëveshjet që i ka nënshkruar Kosova me Shqipërinë, nuk i keni sjellë fare. Vetëm kur shohim që keni shpenzuar shuma marramendëse, po në anën tjetër nuk ka asnjë punë që është bërë në atë drejtim.

Prandaj, natyrisht që unë e mbështesë rezolutën, por duke pasur parasysh që ne kemi një Qeveri që e ka nisur punën me vendime të paligjshme, nuk kemi çka i kërkojmë llogari më tutje.

Ne duhet që të angazhohemi që t'ju rrëzojmë juve. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, sepse ne e kemi parë që për juve nuk është problem shpenzimi i paligjshëm i parasë publike. Fare s'e keni problem.

Madje po thonë që po i shpenzoni paratë publike sikur të ishin të babait. Jo, sepse unë nuk besoj që të babait i kishit shfrytëzuar kështu. Po i shfrytëzoni të shtetit. Po i shfrytëzoni të qytetarëve të Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme. Prandaj, kjo është arsye se pse ju duhet të shkoni në shtëpi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është çudi vërtet sesi mund të debatohet për një temë të tillë pas asnjë dokument përpara të deputetëve përveç thirrjes për seancë të jashtëzakonshme.

Ta kishim pasur një raport nga Qeveria ose nga auditori do të ishim bazuar edhe në të dhënat e tyre, po vërtet është krejt e pakuptueshme edhe nuk po e di pse LDK-ja që disa herë thërret seanca të jashtëzakonshme dhe kush po e nxitë në këtë drejtim që të merr autogol ose t'i kthehet bumerang pa nevojë, kur ka nevojë të mbahen seanca serioze me tema të caktuara. Me dokumente. Me të dhëna konkrete dhe jo të flitet paushall siç është ka flitet.

Këtu është thirrur seanca për shpenzime të paparashikuara në këtë fazë dhe shihet se po kalohet në tema të tjera të pakuptimta dhe po i humbet kuptimi edhe seancës.

Nëse Qeveria i ka bërë shpenzimet në bazë të ligjit janë marrë vendimet, atëherë ta presim raportin dhe të diskutojmë. Por, pas kësaj seancë, unë besoj që çdo seancë tjetër që e ka karakterin ku do të duhej të flitej seriozisht e humb kuptimin sepse po banalizohet në këtë seancë.

Nëse janë bërë shpenzime siç u tha, ajo fjala popullore që thuhet; nëse është ngrënë pitja, tepsia ka mbetur, prisni raportin dhe hyjmë në seancë kur mundemi ta bëjmë vërtetë një debat normal. Një debat çfarë e meriton ky Kuvend dhe jo të flitet për gjëra të cilat as nuk i kemi të dhënat as nuk kemi pse të flasim tash për diçka që nuk kemi një raport adekuat.

Prandaj, kisha kërkuar që të mbyllet kjo seancë pa lidhje dhe të shkojmë në seanca të rregullta e të mira e të domosdoshme për qytetarët e vendit dhe të mos flasim paushall sepse veç po i maltretojmë qytetarët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën. I ke tetë minuta Bilall, sepse i ke harxhuar dy.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti Haliti!

Unë me qëllim desha ta marr fjalën pasi të flasë edhe Qeveria për të dëgjuar dy variantet, versionet, ngase Parlamenti pak ose shumë funksion si gjykata; njëra palë akuzon ndërsa tjetra mbrohet.

Unë edhe pse jam pjesë e mazhornacës nuk jam këtu në funksion për të mbrojtur askënd sepse puna është ajo që e mbron gjithkënd. Pra, puna e mirë ajo që e mbron gjithkënd, ndërsa puna e keqe është ajo që e sulmon gjithkënd.

Për aq sa dëgjova, pashë që këtu kemi të bëjmë me një traditë të vendosur më herët e cila vazhdon edhe nga kjo Qeveri, ndarjen e mjeteve nëpërmjet atij fondit të shpenzimeve të paparashikuara dhe shfrytëzimin për rastet e festave.

Pra, edhe për rastet e sëmundjeve siç u tha këtu që nuk kanë shërim në Kosovë.

Nëse e shohim nuk ka diçka të veçantë nga qeveritë e kaluara në aspektin e bazës qoftë politike, qoftë ligjore. Ajo që mbete t'u parë, jo vetëm për shpenzimet e kësaj Qeverie të këtij viti ose të vitit të kaluar, por edhe të qeverive të mëparshme të shihet tash, jo baza ligjore e miratimit të atyre shpenzimeve, por mënyra sesi janë shpenzuar ato. Ajo nuk i takon besoj Kuvendit.

Nëse Kuvendit i takon për të biseduar se a janë shpenzuar apo jo, a është marrë vendimi në bazë ligjore apo jo? Se a janë shpenzuar në bazë të ligjeve, prokurimit apo ligjeve tjera, kushdo që ka prova duhet t'i thotë natyrisht këtu në foltore dhe t'i prezantojë edhe në prokurori.

Por, shpesh këtu po abuzohet me këtë; shkoni në prokurori. Shikoni, në çdo vend demokratik, kudo që flet një përfaqësues i popullit, madje jo vetëm përfaqësues i popullit, deputet apo ministre, qoftë edhe gazetar, prokurori nuk duhet ta presë që t'i shkojë te zyra deputeti apo ministri apo kushdo qoftë ai i cili denoncon publikisht, por prokuroria duhet t'i bëjë ftesë për të shkuar edhe atje për të deponuar provat, faktet.

Kjo, sa i përket abuzimit me këtë. Kushdo që ka prova të mos flasë këtu po të shkojë në prokurori. Duhet flitet këtu, por edhe në prokurori.

Tash, unë do të ndalem te kjo rezoluta që na është propozuar neve. Së paku unë do ta marr të drejtën që të flas edhe për këtë pjesë.

Në rezolutë thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës të ndalë praktikën e ndarjes së mjeteve financiare pa kritere dhe pa respektuar dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë.

Për sa u pa këtu askush nuk e kontestoi bazën ligjore. Madje u tha që, po ju me letra jeni mirë, me ligj jeni mirë, por kemi dilema se ku kanë shkuar ato para dhe si janë shpenzuar ato para, nën një.

E dyta, këtu u tha që dy javë ka që bëhet fushatë se janë shpenzuar 500 mijë. Sot marrim vesh që janë zotuar 500 mijë, ndërsa si duket shpenzimi nuk kalon mbi 175 mijë. Mbetet të shihet se cila është e vërteta. Pra, tema në këtë seancë, konsideroj që ende pa u kryer të gjitha shpenzimet, pa u bërë pagesat është thirr seanca dhe Qeveria nuk arriti të provojë këtu se a janë shpenzuar 500 mijë apo janë shpenzuar 175 mijë.

Nuk besoj që do të ketë shpenzime shtesë ta zëmë për çështjen e pavarësisë. Kontratat janë lidhur, shpresoj shumë para se të mbahet shënimi i përvjetorit të pavarësisë dhe nuk besoj që ndonjë kontratë do të mund të lidhet pas datë së përcaktuar me vendimin e Qeverisë.

Pika e dytë thotë që, në afat prej një jave Qeveria përkatësisht Zyra e Kryeministrit të sjellë në Kuvendi një raport për procedurat e zhvilluara për të realizuar aktivitete për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.



Unë jam dakord me këtë pikë, por me një kusht; meqë do ta mbështesja këtë pikë. Meqë siç u tha këtu na qenka traditë e të gjitha qeverive që të veprojnë kështu me këtë fond, atëherë Kuvendit t'i sillen jo vetëm për këto dy vjet, por t'i sillen raportet për pesë vjet.

Duke filluar nga viti 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 dhe të shohim se a ka dallim nga viti në vit, ndërsa siç thashë më parë, po e përsëris edhe një herë; kushdo që ka prova se janë keqpërdorur pastaj ato para le t'i thotë këtu në Kuvend gjithsesi dhe le t'i deponojë në vendin ku duhet pastaj sipas ligjit të ndiqet kushdo që ka bërë keqpërdorim.

Nuk është asnjëherë tepër që të flitet për buxhetin. Për paratë. Për shpenzimin e tyre kurrë nuk është tepër.

Pa marrë parasysh nganjëherë kjo shfrytëzohet edhe për propagandë, edhe për të provuar që tjetrin ta nxjerrë keq e veten mirë, pra tjetrin drejt e veten melaqe.

E vërteta është ajo se këtu, po në të ardhmen duhet të shohim që sa më pak nga buxheti, sidomos nga rezervat, të përdoren për shpenzime të paparashikuara. Le të provojmë t'i parashikojmë gjërat e parashikueshme. Natyrisht që ato të paparashikueshmet nuk mund të parashikohen dhe të mos manipulojmë, së paku të mos e teprojmë, të përpiqemi të mos e teprojmë me manipulime, se të thuhet që janë keqpërdorur 500 mijë, e pastaj të thuhet ja që seanca arriti t'i shpëtojë 350 mijë, na del që akuza për 500 mijë paska qenë e paragjykuar, se s'paska qenë e vërtetë.

Kështu që le të debatojmë, të flasim, se në fund të fundit Parlamenti është vend ku debatohet, ku flitet, por të gjykojmë drejt dhe të mos bëjmë militantë në debatet tona, sepse nuk besoj që as korrupsioni, as keqpërdorimet, as malverzimet, siç po thuhet këtu, janë zbuluar nga kjo qeveri apo nga qeveritë paraprake nuk paskan qenë.

Pra, përnjëherë si erdh kjo qeveri gjithçka u bë keq, se ishim shumë mirë në respektim të ligjit, Kushtetutës, ndershmërisë të jashtëzakonshme në përdorimin dhe shpenzimin e parasë publike. Le të qëndrojmë me këmbë në tokë të gjithë dhe kërkojmë nga Qeveria, kjo dhe të gjitha ato që vijnë më pas, çdo kush që është këtu ulur të kërkojë sa më shumë llogaridhënie, sepse natyra e parasë është e tillë, kushdo që është pranë saj ekziston rreziku që ajo të keqpërdoret.

Prandaj, ne jemi këtu edhe qytetarët jashtë dhe instrumentet e tjera të kontrollit të Qeverisë, qofshin nëpërmjet OJQ-ve, qofshin nëpërmjet Auditorit që ta bëjmë sa më të pamundur, ta vështirësojmë keqpërdorimin e parasë publike.

Nëse e kemi në funksion të kësaj, atëherë sigurisht që do t'i shërbejmë vendit, nëse e kemi në funksion të propagandës, atëherë jo vetëm që nuk do të shërbejmë, por vetëm sa do ta përkeqësojmë gjendjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Sot, me të drejtë po flasim për shpenzimin e parasë publike. Unë mendoj që asnjëherë nuk është e tepërt të bisedohet për temat e tilla dhe gjithë ne dhe të gjithë ata që nuk kanë bërë ndonjëherë keqpërdorim me zë të lartë mund të flasin për tematika të tilla.

Mua po më vjen keq që kryeministri e lëshoi sallën, edhe ministri i Financave, kemi pasur nevojë për shpjegime të ndryshme.

Deputetët kolegë të koalicionit qeverisës po thonë që kinse gjithçka paska qenë sipas ligjit dhe sikurse ne parashtruesit e seancës edhe u pajtuam me atë që ka qenë sipas ligjit.

Mirëpo, jo, në fakt, nuk ka qenë sipas ligjit, sepse rezerva shtetërore qëndron aty për shpenzimet e paparashikueshme dhe, siç u tha disa herë, ky nen i Ligjit për menaxhim të financave publike dhe përgjegjësitë është shkelur, sepse janë ndarë mjete për ngjarje, të cilat kanë qenë të parashikueshme dhe i kemi ditur që nga fillimi.

Atë çfarë kemi kontestuar më tepër ka qenë edhe natyra se si është bërë shpërndarja e këtyre mjeteve. Është tepër e vërtetë që debati publik që e kemi ngritur ne, jo seanca e sotme, por atë çka kemi diskutuar që nga thirrja e seancës, si deputetë të opozitës që është diskutuar dhe nëpër media të ndryshme, shpenzimet enorme të Qeverisë të planifikuara sot janë zbritur nga 500 mijë në 170 mijë, sepse ata që kanë planifikuar t'i prodhojnë faturat, të cilat i kanë bërë për disa zëra të shpenzimeve i kanë thirrur mendjes dhe këto shpenzime kanë rënë nga 500 mijë në 170 mijë.

Kështu që nuk mund të themi që ky debat ka qenë pa efekte, debati ka pasur efekt dhe ky efekt është domethënë kursimi i 330 mijë euro taksa të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Është e vërtetë që shpenzime nga rezerva janë bërë edhe në qeveritë e kaluara. Mua, për shembull, më kujtohet shumë mirë rasti në qeverinë e kaluar kur ministri i Bujqësisë, zoti Krasniqi në atë kohë, pati kërkuar nga Qeveria, nuk më kujtohet saktësisht, qindra-mijëra euro për vaksinën për sëmundjen gungore të gjedheve. Kjo me të vërtetë ka qenë shpenzim i paparashikueshëm, sepse askush nuk ka mundur ta parashikojë se fermerët do të përballen me një sëmundje të tillë dhe në atë kohë Qeveria është dashur që t'i gjejë mjetet edhe të ndërhyjë menjëherë.

Kemi pasur mandej shpenzime të paparashikueshme për vërshimet që kanë ndodhur në Klinë, në komunën e Suharekës, mendoj që është në këtë mandat qeverisës, e të tjera.

Mirëpo, ndarja e mjeteve qoftë për sëmundje, qoftë për familjarë të politikanëve, qoftë për ngjarje të tilla dhe shpenzimi i tyre pa kurrfarë kriteri nuk është i justifikueshëm.

Ne nuk guxojmë as në Kuvend, as në Qeveri të bëjmë diferencën në mes të qytetarëve të Republikës, të cilët paguajnë taksa në mënyrë të rregullt dhe neve që jemi të angazhuar në politikë dhe me taksat e tyre marrin pagat dhe benificione të tjera.

Jeta jonë nuk është më e shtrenjtë dhe nuk mund të vlerësohet dhe të konsiderohet si e tillë se sa e qytetarëve të thjeshtë të vendit.

Ne, në fakt, me këto veprime po i shtyjmë qytetarët e vendit që të bojkotojnë institucionet, që të bojkotojnë pagesën e taksave dhe tatimeve dhe të rrisin informalitetin, i cili, siç e dini, që pas luftës ka pasur vetëm rënie.

Në qoftë se ne nuk arrijmë t'i bindim ata që këto taksa të qytetarëve do të shpenzohen për të mirën, për ngritjen e kualitetit të jetës së tyre, atëherë do të krijojmë precedent shumë të dhimbshëm dhe i nxitim ata që ta rrisin informalitetin.

Unë pata dëshirë nga kryeministri, meqenëse po flasim sot për shpenzimin e parasë publike, ta pyes publikisht për një vendim të Qeverisë, edhe pse nuk është në temë, po prapë mendoj që është në temë, se seancat e rregullta po i mbajmë shumë rrallë dhe pyetjeve parlamentare nuk po u përgjigjet as kryeministri dhe as Qeveria, për vendimin e Qeverisë, për ndryshimin e metodës së llogaritjes së akcizës për fabrikën e duhanit, ku pronari kryesor është këshilltari i zotit Haradinaj, zoti Abrashi.

Akciza, kryeministri duhet ta dijë, edhe deputetët nga koalicioni qeverisës, nuk vendoset aty për të penguar ose për të nxitur prodhimin e një produkti.

Akciza vendoset në produkte të dëmshme dhe në produkte të luksit për të penguar konsumin e tyre, vendoset në lojërat e fatit, të cilat konsiderohen që kanë shumë efekte anësore, vendoset në alkool që ka efekte anësore, vendoset në karburante dhe vendoset në plot produkte, siç është edhe duhani, i cili ka efekte anësore dhe qëllimi i vendosjes është që ta zvogëlojë konsumin e tij.

Ne e kemi edhe Ligjin kundër pirjes së duhanit në hapësirat publike dhe ai ligj e ka për qëllim që ta zvogëlojë konsumin pikërisht për shkak të efektit negativ në shëndet që e ka. Mandej mendohet që një pjesë e saj të shfrytëzohet në buxhet për rikuperimin e dëmeve që shkaktohen nga konsumi ose përdorimi dhe çka bën Qeveria Haradinaj, zoti kryeministër. Këshilltari i tij e draftin vendimin për ta zvogëluar akcizën në produktin që ai e prodhon dhe ky e merr një vendim të tillë.

Unë e kam parë, ka pasur reagime edhe nga Zyra e BE-së, zonja Apostollova, e cila thotë që vendimi i tillë e shkel Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, vendimi i tillë krijon konkurrencë jolojale në treg.

Këtë taksë, akcizën, nuk e paguan prodhuesi, e paguan, mirëpo ajo mandej vendoset në çmim të produktit për ta bërë produktin më shtrenjtë. Ne kemi raste të tilla, ku bizneset e grupeve të interesit favorizohen me vendime të tilla, të cilat janë të dëmshme jo vetëm për zhvillimin ekonomik të vendit, po për komplet jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe ka pasur dhe raste të tjera.

Kryeministri ka deklarua në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili asgjë nuk ka bërë në këtë mandat qeverisës, që është duke e shikuar formën se qysh t'i lirojë kompanitë e caktuara në periudha të caktuara nga tatimet. Qysh e bën këtë kryeministri? Ju e dini se kë e liron kryeministri dhe me çfarë kushte e liron kryeministri.

Lirimi nga taksat dhe tatimet bëhet vetëm me ligj, nëpërmjet Kuvendit, si organ më i lartë ligjvënës dhe si përfaqësues i qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Mandej, ne kemi pasur kërkesën në Qeverinë e Republikës së Kosovës për kompensimin e dëmeve nga djegia në fabrika të ndryshme, të cilët rastësisht janë bashkëluftëtarë, bashkëveprimtarë dhe bashkudhëtarë të kryeministrit dhe të koalicionit qeverisës. Në çfarë baze, ne nuk jemi kundër që bizneseve t'u ndihmohet në fatkeqësi të tilla.

Mirëpo kryeministri duhet të tregojë a ka buxhet Qeveria e Kosovës që t'i mbulojë dëmet e të gjitha kompanive që u ndodhin në Kosovë, apo do i zgjedh ato sipas dëshirës dhe kritereve të tij, varësisht a i njeh personat, apo nuk i njeh, e shteti nuk mund të jetë për individ dhe për grupe.

Ne po kërkojmë që shteti të veprojë njëjtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të jetë mbrojtës dhe gardian edhe i taksave të tyre, edhe i bizneseve të tyre, pa dallime partiake dhe pa dallim të përkatësisë politike. Faleminderit!

**KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, urdhëro!**

**TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!**

Sinqerisht, duke mos pasur në Kryesinë e Kuvendit nga grupi ynë parlamentar nënkryetar, edhe për shkak se votat në Kryesinë e Kuvendit vendosin se cila pikë të hyjë në rend dite, unë po e them që kam bërë një kërkesë që katër muaj bashkë me disa deputetë për të thirrur një debat parlamentar, një seancë për pensionet kontributdhënëse dhe që katër muaj po presim për të debatuar, për të diskutuar rreth padrejtësive, rreth mohimit të drejtës elementare që kanë pensionistët kontributdhënës, të cilët kanë punuar me vite të tëra dhe sot marrin një pagesë

simbolike bazuar me pensionin e moshës, të njëjtë me ata që nuk kanë punuar asnjë ditë të vetme, pra duke punua me vite të tëra, por për shkak të përvojës së punës, të cilën llogaritet që të jetë 15 vjet, duke e ditë secili prej neve që atyre u është mohuar e drejta, janë larguar prej punës dhe sot privilegjohej ata që kanë punuar në masa të dhunshme në kohën e ish-Jugosllavisë.

Pra, nuk po vjen në rend dite një kërkesë, e cila po është e vazhdueshme edhe nga Shoqata e pensionistëve, pra që Kuvendi të diskutojë, të debatojë dhe të kërkojmë me ngulmë që Rregullorja që fuqi të shfuqizohet dhe të hiqen pra 15 vjetët, të cilat thashë edhe një herë nuk kanë mundur t'i plotësojnë, ndodh 14 vjet e 9 muaj t'i kenë, por për pak ditë nuk i plotësojnë 15 vjet. Dhe, e gjithë kjo po ndodh, pa u diskutuar kjo seancë, për shkak të këtyre seancave 'hajt pak'.

Pa dashur asnjëherë të vetme ta arsyetoj një euro të vetme të keqpërdorur nga kushdo qoftë, pra pa dashur të arsyetoj një euro të vetme nga kushdo qoftë. Mirëpo, kjo mbarëvajtje ose ky devijim i Kuvendit për të thirrur këso seancash dhe për të lënë prapa seancat që janë shumë të rëndësishme dhe jam shumë e sigurt që të gjitha grupet parlamentare e kanë me interes, nga se secili prej neve mund të jemi produkt i atyre pensionistëve dhe duhet ta shqyrtojmë dhe ta ndalim një të padrejtë që është bërë për këto vite.

Tani më, duke kërkuar transparencën e secilit buxhet, për secilën euro të shpenzuar, mirëpo po i humbim arsyet e thirrjes së këtyre seancave, duke mos kryer detyrat secili komision që është përgjegjës, i kemi 14 komisione, katra të përhershme në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, duke e thirrur në përgjegjësi secilin për t'i diskutuar edhe ato shpenzime.

Më herët u tha sinqerisht se disa prej vendimeve të qeverive nëse nuk kanë rënë ndesh me ligjin, atëherë a kanë qenë të drejta, a kanë qenë të logjikshme vendime që kanë marrë qeveritë. Unë sinqerisht kisha dashur të di a janë të logjikshme, a janë vendime të Qeverisë ose të drejta edhe vendime të Qeverisë Mustafa, ku kanë përfituar familjarët e ministrave të Qeverisë Mustafa.

E kam thënë edhe herëve të tjera, edhe sot po ta di që një vendim i Qeverisë Haradinaj ka përfituar cilido ministër ose cilado familje e ministrit, e cilido ministër, do e bëja publike.

Me vendimin e Qeverisë Mustafa për faljen e borxheve deri në vitin 2009 ka përfitua familja e ish-ministrit të Financave, shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

E kam thënë sa herë dhe a është e logjikshme, a është e drejtë, edhe sot cilido ministër, cilado familje që përfiton me cilindo vendim të kryeministrit Haradinaj, unë do ta bëja publike, nuk është e logjikshme, nuk është e drejtë.

Prandaj, edhe Qeverisë i kisha bërë thirrje që sinqerisht në ndarje të mjeteve për persona të sëmurë rëndë ka pasur raste që kanë përfituar edhe ish-deputet, kolegë tanë.

Pajtohem shumë me koleget e mia kur thonë që ndryshe e kemi një jetë ne, ndryshe e ka qytetari, njëqind për qind pajtohem.

Dhe, në kuadër të kësaj është shumë mirë që t'i ndahet buxhet një qytetareje, e cila po kërkon derë pas dere, Shyhrete Lumës, nga Cërmjani i Gjakovës, e cila ka qenë pjesë e luftës gjatë gjithë kohës dhe është një familjare, e cila kërkon ndihmë dhe është mirë t'i lëmë edhe të tjerët si deputetë, pa marrë parasysh sëmundjet që mund t'i kemi secili prej neve.

Dhe, në këtë kuadër, them edhe një herë, po, llogaridhënie duhet të kërkojmë, se ne jemi ata që kërkojmë llogaridhënie nga cilado ministri dhe nga cilado institucion i ngritur, qoftë edhe prej Kuvendit.

Por, të mos thirrën seanca, nga se e kemi parë edhe më 5 mars, kur kjo seancë është thirrur në atë ditë të shënuar të Epopesë së Jasharajve dhe vetë nga iniciuesi u kërkuar të shtyhet për sot. Pra, edhe ajo ditë, edhe sot, edhe data të tjera po e mohojnë të drejtën për të mbajtur seanca që kemi kërkuar për katër muaj, ka edhe të tjera që po presin rend dhe nuk po vinë në rend dite, e që janë shumë urgjente.

Prandaj, ju kisha lutur edhe një herë, Kryesi e Kuvendit, të bëni rendin e ditës, të jepni edhe ju nga subjektet tuaja parlamentare, të ngritni këto shqetësime për të mbajtur seanca, të cilat janë thirrur me kohë, por të cilat nuk po vijnë në rend dite pikërisht për shkak të këtyre seancave.

Pra, edhe një herë, presim një raport të auditorit dhe do të diskutojmë për secilën dhe unë jam këtu për t'ju thënë. Nuk e kuptova mirë sinqerisht zotin Zeka për Riinvestin, është mirë edhe për neve si deputetë, po edhe për qytetarët të dinë, ndoshta Lumiri është mirë të marrë fjalën edhe të na tregojë, nuk po flitet për një euro as për një mijë euro, po për milion e sa euro. Atëherë për cilindo euro të shpenzuar është mirë Lumiri të na tregojë këtu, sinqerisht nuk e kuptova dhe është mirë të di pra për cilindo euro, e jo për më shumë se një milion euro.

Pra, t'i ndalim këto gjëra, sepse qytetari është ngopur. Sinqerisht është ngopur me këto tema 'hajt pak', po edhe pse edhe këtu ngritën çështjet të cilat e rregullojnë jetën e qytetarit.

Mirëpo, unë konsideroj, po flasim për diçka që nuk kemi raport, e tash po paragjykojmë se ndikuar që të ulen ato shpenzime. Jo, more, nuk mund të bëhet këtu brenda dite të ulen shpenzimet, pra llogaridhënia po, raporti i auditorit po, edhe po diskutojmë për cilindo euro të shpenzuar.

Mirëpo, nuk e kuptova, edhe një herë kërkoj nga zoti Abdixhiku të na shpjegojë mirë atë si profesionist financiar çështjen e Riinvestit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Hykmete Bajrami e ka kërkuar fjalën për replikë.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, nënkryetar!

E para, zonja Haxhiu që sa herë po e përmend rastin e faljes së borxheve ndaj ndërmarrjeve publike.

Qeveria Mustafa, në atë kohë kryeministri Mustafa dhe ministri i Financave, zoti Hoti, asnjë individ, asnjë familje, asnjë qytetari në Republikën e Kosovës nuk e ka thirrur në zyrë i t'i thotë që po e marr një vendim e po t'i fal borxhet. E kemi bërë një ligj, sepse kemi konsideruar të nevojshme, se ka pasur borxhe ndaj ndërmarrjeve publike që me 17 vjet nuk kanë qenë të shlyera dhe kemi bërë një prerje me datën e pavarësisë. Faljen e borxheve e kemi kushtëzuar me pagesën e të gjitha faturave pas shpalljes së pavarësisë dhe, po, janë falur me qindra-miliona euro borxhe, po janë falur të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës me votat e shumicës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe po besoj se edhe ju keni votuar në atë kohë për, nëse s'keni votuar, keni bërë gabim dhe kanë përfituar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Po ajo çka ka qenë, ne nuk jemi bërë meritore, as kreditorë dhe as aksionarë të asnjë biznesi që ka përfituar nga ky ligj, sepse 120 deputetë me votën e tyre kanë vendosur në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për dallim prej kryeministrit Haradinaj, i cili i thërret pronarët e kompanive në kabinetin e tij, i fal 56 milionë borxhe dhe thotë "i kam falë se mu ka tek". Po me ata pronarë ai shkon në pushime në Zvicër, e pushimet e tij e dimë sa kanë kushtuar, kështu ka pasur deklarime në media. E për të na treguar e të dalë publikisht se kush po përfiton prej vendimeve, se i kemi parë edhe për autostradën për Gjilan edhe plot të tjera vendime, i dimë krejt, janë sekrete publike kush po përfiton, po që e kemi një rast personal...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit! Përkundër që unë nuk e luaj rolin e zëdhënëses këtu, është mirë se zoti Hoti ishte këtu, kurse kolegja e merr fjalën, është mirë të paraqitet vetë ish-ministri, pra edhe një herë po them, a është e logjikshme, e nderuar, duke qenë me përvojë si ministre që keni bërë punë, se e dimë të gjithë, a është e drejtë, e logjikshme që të përfitojnë familja juaj apo imja, apo e ministrit të Financave që do të duhej të ishte shembulli më i mirë, cilido ministër qoftë të përfitojë familja. Pra, a ka qenë e logjikshme, e drejtë që familjet tona të kenë borxhe? Jo! Falja e borxheve, për çka edhe unë kam votuar, ka qenë për qytetarët, po jo në mesin e atyre

qytetarëve, se ju më herët e thatë krejt të kundërtën, ku mund të barazohemi ne me qytetarët, kurse tani po thoni krejt të kundërtën.

Pra, ka përfituar familja e ministrit të atëhershëm të Financave. Pra, a e quani të drejtë këtë?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ne sot e kemi një temë të caktuar, çfarëdo qoftë, shpenzimet të ashtuquajtura të paparashikuara nga rezervat e shtetit. Që në fillim unë po e them, jam jashtëzakonisht i shqetësuar me qëndrimet e kolegëve deputetë parlamentarë, se kjo qenka seancë pa lidhje, s'paska pasur nevojë, s'duhet të diskutohet për këto çështje, edhe bile-bile, me propozime konkrete që seancat e jashtëzakonshme që janë e drejtë legjitime e deputetëve, kushtetuese, në njëfarë mënyre të kufizohen, të reduktohen apo të ndalohen krejtësisht. Nuk ka detyrë tjetër Kuvendi, një Parlament, Kuvendi i Republikës së Kosovës përveçse të kontrollojë Qeverinë dhe zbatimin e ligjeve dhe të nxjerrë ligje të reja, nuk ka diçka tjetër. Unë nuk di çka mund të bëjmë diçka tjetër ne këtu, e mandej dalin zëra se për këtë nuk duhet diskutuar, është një çështje absurde.

Çështja tjetër, unë dëgjova për patriotizmin e madh se seancat janë propozuar me 5, 6 apo 7 mars. Shumë në rregull, edhe unë pajtohem, zonja dhe zotërinj deputetë, kolege të nderuar, 5, 6 dhe 7 mars nuk janë festa zyrtare. Hajde, e keni shumicën bashkë po i bëjmë festa zyrtare, dhe në festa zyrtare nuk organizohen seanca të Kuvendit. Po jo të luhet me patriotizmin e qysh u bë, e çka ngjau? Ata që kanë vdekur për lirinë e këtij vendi nuk e kanë kufizuar një gjë të tillë dhe nuk kishin për të kërkuar kurrë të kufizohemi. Ne kemi mundësinë që 5, 6 dhe 7 mars t'i shpallim festë zyrtare të Republikës së Kosovës.

Çështja e shpenzimit të rezervave shtetërore, para nja 20 vjetësh kam dëgjuar një mësimdhënës universitar, jo këtu, duke thënë se rezervat ndahen nga buxheti i rregullt, për arsye se ato janë mjete që ndahen për çështje urgjente, të jashtëzakonshme. Natyrisht ndahen nga buxheti, por për raste të jashtëzakonshme. Sigurisht është një pyetje shumë e madhe për të gjithë njerëzit, edhe në Republikën e Kosovës, edhe gjithkund, rezervat janë 4.8 milionë, kurse harxhohen 8 milionë euro. Domethënë, ka dalë përtej rezervave, ku janë marrë ato mjete? Kjo është një çështje që duhet të diskutohet, sigurisht gjejnë edhe për këtë arsye, mirëpo ky është një problem, të merren 300 euro dhe t'i harxhosh 600 euro, duhet gjetur edhe burimin prej nga vijnë ato. Njerëzve duhet t'u tregohet drejt, por diçka është duke ngjarë këtu. Çka është duke ngjarë, nuk është me rëndësi, po shihet që s'ka rëndësi për shumë kolegë.

Një çështje tjetër, nga këto mjete të rezervave që janë ndarë për raste të paparashikuara, unë do t'i marr dy shembuj të njerëzve të thjeshtë që lëndojnë çdo qytetar të Republikës së Kosovës. Për



një rast, të një funksionari, nuk po dua t'i përmend emrat për shkak të empatisë edhe rasteve tragjike, kemi dy raste të vdekjeve. Vdes një funksionar i këtij shteti, në një rast ku ka shkuar për argëtim, domethënë nuk prodhon mjete, por shpenzon, konsumon mjete dhe i ndahen 15 mijë euro. Në anën tjetër, brenda pak ditëve, më parë ose më vonë, vdes punëtori në vendin e punës, qytetari i Republikës së Kosovës që krijon mbivlerë në këtë vend, paguan tatim, vdes sikur ky, vetëm ai në vendin e punës, ai krijon mjete, kurse ky shpenzon mjete, për të nuk ndahet asnjë mjet. Kjo është ajo që duhet ta shtrojmë, a janë këta qytetarë të Republikës së Kosovës të barabartë, apo s'janë?

Ne e kemi një Ligj për diskriminimin që thotë “çdo dallim, çdo përjashtim, kufizim ose preferencë në bazë të ndonjëres nga karakteristikat”, e aty ka shumë karakteristika, por unë po i përmend karakteristikat që e kanë bërë dallimin në rastin e ndarjes së mjeteve, janë: origjina sociale, gjendja sociale ose personale, gjendja martesore a familjare, edhe gjendja pasurore. Kisha dashur shumë të jetë këtu kryeministri ose ministri i Financave dhe të më tregojnë në bazë cilës normë morale apo ligjore një funksionari që ka qenë për argëtim, fatkeqësisht për familjen edhe për krejt, ka vdekur, i ndahen 15 mijë euro, edhe një punëtori që vdes në vendin e punës, pa marrë parasysh a është sektor privat a publik, nuk i ndahet asnjë mjet! Kjo kishte me qenë për mua një përgjigje shumë interesante.

Unë, natyrisht i dëgjova të gjithë, populli thotë “nxirr një kashtë e dalin gjashtë”, nëse ky nuk është qëllimi i një Kuvendi të nxjerrë një kashtë e të dalin gjashtë për shpenzimet e Qeverisë, për manipulimin, edhe manipulimin mos e merrni në kuptimin negativë, domethënë për përdorimin e parasë publike, unë nuk e di çfarë çështje tjetër kemi më të rëndësishme. Ne, natyrisht jemi mësuar të ketë seanca vetëm për çështje të mëdha patriotike, çështje të mëdha politike, gjeostrategjike, por për këto çështje jo. Të gjitha çka u thanë, u nxorën shumë informata, edhe unë mendoj se janë çështje për të cilat duhet të diskutohet. Nuk ka çështje më të rëndësishme se këto për një Parlament.

Zonja deputete Bajrami e përmendi Kombinatin e Duhanit në Gjilan. Ajo është shkatërruar, zonja Bajrami, është shkatërruar, disa qindra punëtorë ose mijëra punëtorë kanë mbetur papunë. Disa dhjetëra-mijëra njerëz që kanë punuar në bujqësi për Kombinatin e Duhanit kanë mbetur pa të ardhura, nga privatizimi asnjë nga punëtorët nuk e ka marrë asnjë cent tash dhjetë vjet, dhe gjendja e Kombinatit të Duhanit nuk dihet cila është. Domethënë, njerëzit kanë mbetur pa pensione, pa kontributin 20%, kanë mbetur dhjetëra-mijëra njerëz pa burime të jetës dhe sot luhet, dëgjohet se ky person i afërt me këtë kryeministër apo me atë kryeministër, po tash thuhet me kryeministrin aktual, i ka duart e zhytura në atë kombinat, që ka qenë burim i jetës për disa mijëra banorë të Kosovës, sidomos të Anamoravës.

Unë mendoj se do të ketë edhe seanca të tjera të jashtëzakonshme, edhe ato kisha dashur, kisha dëshiruar t'iu kushtohen pikërisht kontrollimit të veprimeve të Qeverisë në raport me mjetet dhe

me paranë publike nga ky Parlament. Më mirë është të gabohet ashtu, se sa të heshtën. Edhe një çështje, këtu gjithçka u tha është bërë me letra, shumë e natyrshme, një detyrë e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është t'i reduktojë, t'i ndalojë seancat e jashtëzakonshme, por është në të vërtetë të gjenden vrimat ligjore dhe legjislacionin ta kompletojmë. Unë ende nuk dëgjova çka domethënë "shpenzime urgjente". As në Ligjin për mbikëqyrjen e financave publike nuk gjeta askund një definicion se çka domethënë togfjalëshi "shpenzim publik", ka definicione të ndryshme, por ajo që është kryesorja, edhe të tregohet një herë, nëse qenka një përvojë e keqe në dhjetëra vjet për shpenzimin e rezervave, hajde ta ndalojmë këtë punë të keqe, këtë përvojë të keqe, sepse ka të bëjë me rezervat e shtetit që janë për rastet e jashtëzakonshme, urgjente, që nuk kanë të bëjnë me gjërat krejt të zakonshme, për shembull, të jepen qindra-mijëra euro për publikimin e një libri, të një njeriu që s'ka asnjë vlerë, as politike, as kurrfarë vlere, përveç personale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

**EMILIJÀ REDŽEPI:** Zahvaljujem se potpredsedniče, gospodin Haliti!

Nisam želela da se javim za ovom govornicom danas iz razloga za to što sam član Komisije za nadgledanje javnih finansija, istom s obzirom da u Komisiji nam nije došao raport o zloupotrebi državnog novca od strane Vlade, niti imamo izveštaj od strane državnog revizora. Smatram da trebamo sačekati da o tome prvo raspravljamo u Komisiji, pa tek onda da dođe u Parlamentu na diskutovanje.

Mene nešto drugo zanima i sms koje primamo od mojih građana, od naših građana, koji ne govore albanski jezik ili ga slabo razumeju, pravilo ovog Parlamenta g. Pod predsedniče jeste da ne poštuje se Zakon o jezicima, odnosno nemamo direktno prevod na našoj državnoj televiziji za zajednice, za hiljade i hiljade ljudi koje govore bosanski, srpski, hrvatski, crnogorski ili drugi jezik, nisu u stanju da prate zasedanje ovog parlamenta, i pravilo ovog parlamenta jeste da kada poslanici Liste Srpske nisu u sali, mi ovde nemamo prevod.

Ne samo što mi nemamo prevod kao poslanici, a nema drugih ovde od manjinskih zajednica nikad da podignu glas, osim mene, smatram da naši građani koji u dovoljnoj meri ne razumeju albanski jezik ili ne poznajuga sup po ovom pitanju diskriminisanje i molim parlament, odnosno administraciju parlamenta da se pozabavi time, jer ne govore samo predstavnici Liste Srpske tim jezikom.

Takođe želim da neko od poslanika iz opozicije komentarisao da se zloupotrebljavaju sredstva od strane Ureda premijera, odnosno kancelarija za prava interes zajednica, gospodo hvala Bogu, da napokon imamo i mi vrata gde da pokucamo kada su nam potrebni razno razni projekti, odnosno pomoć oko zdravstvene zaštite oko operacija, oko pružanje građevinski materijala o socialno ugroženim slučajevima ili samohranim majkama, kancelarija za zajednice, ja sam

poslanik od 2009. godine je bila mesto za zloupotrebu državnog novca za jednu usku grupaciju ljudi, ja sam to često iznosila u ovom parlamentu, ne kažem da celokupnu srpsku zajednicu, nego za deo te populacije i hvala bogu da sada nije tako i da ostale zajednici i ostali narodi koji žive na Kosovu imaju pravo da koriste taj novac.

Tako da sve ono što kažete u tom pravcu je pogrešno, i smatram da smatramo da smo svi ravnopravni na toj osnovi, i ne želim da se o tome diskutuje. A što se tiče zloupotrebe državnog novca, pa zar mi gospodo nemamo agenciju za anti korupciju, zar nemamo pravosudni sistem, zašto te agencije ne odrede svoj posao, zašto mi ovde poslanici raspravljamo o tome, čak se spominju imena pojedinaca, pojedinih političara, a niko o tome ne raspravlja i ništa se ne preduzima povodom toga da se to spreči.

Trebate svi, jasno i glasno reći bilo ko da je, iz bilo koje Vlade, bilo ko od ministara od poslanika, jer i u politici imate čiste ljude koji nikad nisu zloupotrebili državni novac, i ja saosećam sa vama kada o tome govorite a ne mogu dozvolite da svi budemo na ravnopravnoj osnovi tretirani u tom smislu. Zahvaljuje se!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

**ARBËR REXHAJ:** Faleminderit!

Para se ta them atë që e kam pasur ndërmend, po dua të flas për këto tre ditët, 5, 6 dhe 7 marsin. Në të vërtetë këtu na është thënë që ne kemi gabuar që kemi thirrur seancën për 5 dhe 6 mars, të cilat kanë qenë seanca të jashtëzakonshme. Kjo edhe mund të jetë e drejtë për shkak të datave, por nuk mund të jetë e drejtë për shkak të temave, sepse temat, të cilat ne i kemi thirrur kanë qenë tema me interes kombëtar. Por, më 7 mars, pra ndodh hipokrizia, derisa koalicioni PAN thotë që nuk duhet të thirret seancë për Epopenë e UÇK-së, ata thërrasin seancë pikërisht në këtë datë që ta votojnë Projektligjin për dialogun dhe platformën dhe i bëjnë favore në ditën e dhembjes krenare pikërisht Serbisë.

Prandaj, është hipokrizi edhe ajo që e tha një deputete këtu, e cila nuk po ia përmend emrin, sepse nuk është në sallë dhe nuk është parimore t'ia përmend. Tash, po kaloj në temë, Qeveria Haradinaj është qeveri e paparashikuar, rrjedhimisht edhe shpenzimet e paparashikuara nga buxheti rezervë nuk përbëjnë ngjarje të jashtëzakonshme. PAN-i ishte e paparashikueshme në kontekstin sigurisht se negativ dhe, me gjithë këto kjo qeveri parandë publike e ka harxhuar në mënyrë të paparashikuar, buxhetin e ka orientuar aty ku ka dashur në formë klandestine. Ua ka përmbushur apetitet grupeve të vogla të interesit dhe rrjedhimisht e ka dërguar në komunat ku i kanë parë si kosto elektorale dhe jopërmbytësore, jo aty ku pasur mungesa dhe ku ka pasur nevojë. 53 euro për kokë banori në Deçan, ndërsa 8 euro për kokë banori në Prizren, e plot shembuj të tjerë të pabarazisë në komunat e tjera.

78 milionë e 500 mijë euro për shpenzime për asfalt dhe 0 shpenzime për Trepçën. Investime kapitale në arsimin parauniversitar janë 7 herë më të vogla se sa shpenzimet në asfalt, pra veç paramendojeni, e goditën sektorin privat dhe aftësinë e saj konkurruese, rrjedhimisht në këtë rast pabarazia do të jetë shumë më e madhe. Këtë vit 500 mijë euro të harxhuara, pra gjysmë milioni euro për Pavarësinë e Kosovës, ne pamë vetëm një paradë të FSK-së.

Kryeministri këtu tha që janë harxhuar 100 e sa mijë euro, të tjerat kthehen, mirëpo unë nuk mund ta kuptoj idenë e asaj se si kërkohen 500 mijë dhe nuk mund të harxhohen as gjysma, jo vetëm nëse në mënyrë paragjyquese ka tendenca për keqpërdorime. Me kaq para shumë aktivitete do të duhej edhe të ndodhnin. Nuk ndodhën. Prandaj, ministri i Financave, i cili nuk është këtu së bashku me Kryeministrin, sepse janë të përgjegjshëm të dy, duhet të tregojnë cent për cent ku janë harxhuar po keqpërdorur këto mjete. 115 mijë euro për Komisionin për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Ndonëse nuk ju mjaftoi pra që i dhamë tokë Malit të Zi, edhe paranë e qytetarëve e harxhojnë në takimet e studimit të këtij dokumenti, në fakt që parimisht është në rregull, por që në fund as nuk i dëgjuat rekomandimet e tyre, sepse ai dokument ishte aktakuzë për demarkacionin. Realisht për delimitimin e kufirit, të mos e quaj demarkacion, duke i lënë jashtë pra 8 200 hektarë tokë.

Qeveria Haradinaj me shokët e tij është qeveri e klientelës, keqpërdorimit të buxhetit, korrupsionit dhe kimit institucional. Në Qeverinë e tij, anëtari i Bordit të Telekomit, siç e patë para disa ditësh, punëson katër fëmijët e tij. Ndërsa, çka është më eklatante edhe skandaloze madje, gjatë muajve të fundit, janë punësuar shpejt e shpejt 600 militantë të tri partive politike të koalicionit. Pra 600. Askund në botë nuk mund të gjeni shkelje flagrante, keqpërdorime të tilla, as me një kërkim në Google. Pra, kërkoni dhe nuk mundeni. Madje as në vendet e botës së tretë, fatkeqësisht po e them, edhe po e them për keqardhje. Rrjedhimisht Kosovën e kemi shndërruar të gjithë ju si vend i botës së tretë.

Tash po kaloj te ai filmi, i cili u fol. E sponsoroni një film me 180 mijë euro, tash shtrohet pyetja pse ky film? Sigurisht se shtrohen këto pyetje, sepse kanë edhe pikë çuditëse. Pse duhet të merrem para nga buxheti rezervë për një film? Apo ndoshta pse aty ndonjëri ka me ndonjërin nga qeveritarët. Paramendoni në buxhetin shtesë merren para, ndërsa këtë do të mund ta parashihet shumë lehtësisht pra në buxhetin e vet Ministria e Kulturës, pra ta shtynte përpara një film. Pse?

Që në fakt, ekziston një shprehje te ne te populli, që kjo qeveri është bërë hor atë po e dimë, por unë kam dilemë a ka atë konceptin e skuqjes në ndërgjegjen e vet. Sigurisht që jo. Kryeministri duhet të përgjigjet për qindra e mijëra euro, të cilat i ka ndarë për këto projekte. Pse ka marrë vendim për ndarje nga shpenzimet e paparashikuara për rastet për të cila nuk nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara? Cilat janë këto rrethana që kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë dhe të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen? Ndoshta, mund të ketë ca të tilla, pra siç kam parë aty, por jo në numër kaq të madh dhe jo në

mjete kaq të mëdha. Paramendoni, keni ndarë 10 mijë euro që ua keni dhënë familjeve të zyrtarëve policorë, të cilët kanë humbur jetën në Kaçanik. Shumë dakord jam edhe unë. Shumë më pak se familjarëve të cilët janë familje pra të politikanëve. E pse kjo pabarazi? Çka kanë ata policë, ose mund të jenë edhe me profesione të tjera, të cilët janë të pabarabartë me ne? Pra, çka dallojmë ne nga ta? Pse kjo pabarazi kaq e thellë? Pse ky hendek shoqëror këtu në Kosovë?

Prandaj, kjo është tmerruese, dhe është për të ardhur keq për nivelin e konceptimit të gjërave, sesi siç i shihni ju edhe si Qeveri edhe si komplet si PAN. Dhe këtu u tha se kanë qenë konform ligjit. Unë po jua them, pjesa më e madhe e këtyre ndarjeve janë realizuar në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku parashihen kushtet për ndarjen e këtyre mjeteve. Prandaj, kjo Qeveri që shpërndan para kuturu, keqpërdor ato, hendekun mes publikes dhe private e ndan, e keqpërdor dhe e vjedh paratë publike, duhet të shkojë, siç u tha këtu nga shumë shokë e shoqe opozitare, në shtëpi sa më shpejtë. Sigurisht, kjo është sa më shpejt as më mirë edhe për qytetarin e Republikës së Kosovës.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Drita Millaku e ka fjalën.

**DRITA MILLAKU:** Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Seanca e jashtëzakonshme të cilën sot e kemi thirrur është e një rëndësie të veçantë, sepse si temë diskutimi ka komentimin dhe vlerësimin e vendimeve të njëpasnjëshme të Qeverisë Haradinaj, e cila pothuajse çdo ditë shpenzon mjete të konsiderueshme parash, dhe ato nga rezervat shtetërore, mjete të cilat me ligj rregullohen se çfarë destinimi duhet të kenë. Pra mbulimin dhe përkrahjen e situatave dhe gjendjeve të paparashikuara dhe urgjente, të cilat mund të paraqiten nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, apo edhe nevojat e tjera të cilat mund të lindin në të ardhmen.

Ramush Haradinaj me t'u bërë kryeministër, si duket karrigia e kryeministrit e joshi më tepër sesa që duhet. Veprime të cilat filloi t'i ndërmarrë ishin sa të ngutshme, aq edhe të gabueshme. Buxheti i vendit nga kjo Qeveri nuk llogaritet si diçka publike dhe e shenjtë për funksionimin e jetës shoqërore, por atë e konsideron si kuletë personale dhe e menaxhon ashtu siç ia do qejfi, sepse edhe praktikant e kaluara të Qeverisë së partnerëve të tij në koalicion, të njëjtën gjë e konsideronin buxhetin shtetëror si diçka personale dhe private. Dhjetëra miliona euro i dhanë Behtel-Enka-s dhe ende sot e kësaj dite nuk e kemi të qartë arsyen se pse iu dhanë këto mjete dhe ku shkuan, sepse me këto mjete mund të kishim ndërtuar dhjetëra shkolla dhe spitale, bile nga ato më modernet.

Pastaj u mor vendim për kompensimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të qytetarëve serbë, të cilët i shkaktuan në veri të vendit. Mbi 1 milion euro. Dhe, me këtë rast u diskriminuan qytetarët të cilët e paguanin rregullisht shërbimin që e merrnin.

Për të mos mjaftuar këto veprime, shpërndahen mjete të konsiderueshme për përvjetorë, manifestime e festa të ndryshme, duke mos parë të arsyeshme që këto mjete t'i përdorim për situata emergjente e humane. Për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë u ndan 600 mijë euro, siç thanë edhe parafolësit. Plus 255 mijë euro i keni ndarë përsëri në emër të borxhit për përvjetorin e dhjetë të pavarësisë. Ndërsa për përvjetorin e 11-të të pavarësisë i keni ndarë 500 mijë euro, e në emër të borxhit, po presim gjatë vitit se sa do t'i ndani.

Për mbështetje humane keni ndarë për Bujar Bukoshin 30 mijë euro, mirëpo sipas informatave që i kemi janë ndarë tri herë nga 30 mijë euro. Ndërsa, për rastin e Dacit janë ndarë 15 mijë euro. E keqja e kësaj është që familjarëve të policëve të cilët e potencuan edhe shumica e kolegëve të mi, policëve nga Kaçaniku, u keni ndarë vetëm nga 10 mijë euro. Kjo i bie që jeta e një qytetari nuk është më e vlefshme sesa e një qeveritari, sesa e një njeriu që e mban rendin dhe ligjin. E të mos flasim më për humbjen e jetës në vendet e punës, siç janë në fshatin Lubizhdë të komunës së Prizrenit, në fshatin Zhur, në fshatin Mushtisht të komunës së Therandës dhe as që janë marrë parasysh nga Qeveria.

Kjo Qeveri ndau 120 mijë euro për një mbledhje prej dy qeverive që është mbajtur në Pejë, ku njëjtë pa kurrfarë rezultati. Pra për një fotografi me shqiponjë 120 mijë euro, bile një pjesë e tyre as shqiponjën nuk ditën ta bëjnë.

Janë ndarë 200 mijë euro për Programin Nacional për Rini. Edhe kjo pa kurrfarë rezultati. Vetëm në Krushë të Madhe dhe në fshatin Zhur janë larguar 600 të rinj, pra një pjesë e madhe e rinisë dhe ikje të tilla kemi pothuajse në secilin fshat dhe në secilin qytet të Kosovës. Pra, ky është investimi i të rinjve.

Për Dokufest, festival që e promovon Kosovën në Evropë dhe në botë, i keni ndarë vetëm 20 mijë euro.

Në Kosovën e pasluftës nuk di a ka pasur ndonjë qeveri më të madhe se kjo në numër? Me gjithë ata ministra e zëvendësministra, këshilltarë, duke e rritur kështu koston e mbulimit të shpenzime të saj në paga, mëditje, lukse dhe lukse të tjera. 22 ministra në muaj shpenzojnë 99 mijë euro, ndërsa në vit 1 milion e 200 mijë euro. Ndërsa shpenzimet e 88 zëvendësministrave e kapin shumë 240 mijë euro, ndërsa në vit 2 milion e 880 mijë euro. Të mos flasim tani për këshilltarët, shoferët, truprojet, sepse as vetë nuk e dini sesa janë.

Është për t'u çuditur sesi po rri në këmbë ky shtet dhe shumë i fortë kishte qenë. Kam kërkuar të njoftohem se sa paguan qira Qeveria për objektet të cilat i shfrytëzon dhe asnjëherë nuk kam mundur të gjejë askund se sa është shuma që paguan Qeveria edhe pse e di që me miliona euro paguan kjo Qeveri për qiranë e objekteve të cilat i shfrytëzon.

Çka mbetet tejet shqetësuese për këtë Qeveri është praktika tejet e ligë e saj, sepse mundohet ta menaxhojë buxhetin e shtetit në të njëjtën mënyrë siç e bënë edhe qeveritë e kaluara për të shpërndarë mjete financiare vetëm që të përvetësojnë për vota subjekteve të tyre përkatëse.

Fakt tjetër shqetësues është se rezervat shtetërore të cilat janë të ndara ekskluzivisht për nevoja urgjente dhe të paparashikuara për vitet në vijim, të cilat sillleshin rreth 5 milionë euro, dhe më shumë se gjysma e tyre tani veç janë shpenzuar për manifestime, nevoja të tjera të cilat as nuk janë urgjente e as humane, për çka edhe janë të destinuara edhe me ligj për shpenzimin e financave publike.

Pra është koha dhe momenti të mobilizohemi të gjithë së bashku, të ndalojmë njëherë e përgjithmonë këtë praktikë abuzive me paranë e qytetarëve dhe t'ua bëjmë të ditur që prona dhe paraja publike mbeten përherë publike në shërbim të kërkesave të qytetarëve dhe shtetit e të mos keqpërdoren për interesa të ngushta. Ka të tillë në këtë Qeveri që mendojnë sesi t'i shfrytëzojnë në maksimum ditët që u kanë mbetur në pushtet, për përfitime personale, sepse kanë filluar të ndjejnë erën e zgjedhjeve dhe rrënimin e kësaj qeverisje tanimë vetëm të rrënuar.

Pra, qytetarë të nderuar të Kosovës, ne si opozitë jemi mbledhur sot në këtë seancë t'ju njoftojmë me atë se çfarë është duke ndodhur me shtetin tonë, ashtu edhe me paranë publike, me djersën tuaj, e cila ka rënë në dorë të keqpërdoruesve të cilët pa pikë mëshire nuk po mendojnë për gjendjen në të cilën ndodhen kategoritë e ndryshme sociale, siç janë ë rinjtë dhe pleqtë tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë më shumë e kam pyetje. Po më duket edhe ish-ministri i Financave është këtu. Bëhet fjalë për një vendim të datës 23. 3. 2016. nënshkruar nga asokohe Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, e cila thotë ndahen mjete financiare në vlerë prej 250 mijë euro për realizimin e planit për subvencionimin e projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Mjete financiare nga pika 1 e këtij vendimi, ndahen nga shpenzimet e paparashikuara dhe nënprogrami shpenzimet e paparashikuara, me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës dhe programi përkrahja institucionale për kulturën, me kod 80300. D.m.th. informatat tona thonë se ky projekt përkundër faktit që mjetet janë ndarë, vendimi është marrë, projekti s'është realizuar kurrë. A bën të na tregosh çka ka ndodhur meqenëse keni qenë në Qeveri asokohe?

KRYESUESI: Zoti Hoti ka kërkuar replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ai ka qenë vendim i Qeverisë për ndarjen e mjeteve për Qendrën që është përgjegjëse sipas ligjit për të financuar projekte filmike. Por Qeveria e atëhershme, Qeveria Mustafa nuk është bërë regjisore e filmave siç ka ndodhur tash, kur Qeveria Haradinaj vlerëson, Qendra thotë jo të financohet e këta bëhen më regjisor sesa Qendra që sipas ligjeve është e thirrur si i vetmi institucion publik për të ndarë mjete për filma. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj-Bujupi ka replikë. Kundër-replikë, në fakt.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Nëse atëherë ka qenë vendim i Qeverisë, edhe tash është vendim i një qeverie tjetër. Por unë e bëra pyetjen shumë më konkrete. Meqë e keni edhe urdhëresën ku thotë: obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi, vendimi ka hyrë në fuqi, rrjedhimisht paratë janë dhënë, por projekti nuk është realizuar.

Ku kanë mbetur paratë shumë shkurt.

KRYESUESI: Po z. Hoti sqaroje, meqenëse po paraqitesh vullnetar.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesues për mundësinë që të përgjigjem.

Unë e qartësova besoj. Ne nuk jemi bërë regjisor cilin film ta financojmë. Është ndarë mjete për Qendrën Kinematografike që sipas ligjit ndan mjete për filma. Nuk jemi bërë regjisor sikur Qeveria Haradinaj cilin film ta financojmë, e para.

E dyta ka pasur mundësi atëherë zonja deputete që të luajë rolin e opozitës, të ftojë ministrin e Financave, Kryeministrin në interpelancë, po ka qenë e zënë atëherë me dhunë këtu në Kuvend dhe duke gjuajtur gaz në çdo seancë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit kryesues!

Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Deputetë të nderuar,

Është e vërtetë që Kosova po përballet me çështje madhore të cilat kërkojnë përkushtim të madh, e i cili po mungon. Por, kjo nuk do të thotë që në këtë moment nuk duhet Kuvendi të merret me çështje po ashtu shumë të rëndësishme siç është menaxhimi ose keqmenaxhimi i buxhetit të vendit.

Është joserioze përpjekja që keqmenaxhimin e Qeverisë aktuale ta arsyetojmë me shpjegimin se edhe qeveritë paraprake kanë keqpërdorur, gjë që është e vërtetë. Është e vërtetë se të gjitha



qeveritë e pasluftës kanë keqpërdorur dhe është po ashtu e vërtetë se asnjëri nga qeveritarët që kanë keqpërdorur nuk është përgjegjës për keqpërdorimet e bëra. Të vetmit që kanë pësuar për çështjen e keqpërdorimeve janë ata zyrtarë të ndershëm që vetë nuk kanë keqpërdorur, por që kanë bërë përpjekje t'i bëjnë publike keqpërdorimet e të tjerëve, siç është rasti edhe i para disa ditëve në Ministrinë e Arsimit ku një zyrtare e cila përpiqet t'i bëjë publike keqpërdorimet dhe shkeljet në sektorin e arsimit, brenda ditës i ndërrohet vendi. Raste të tilla në Kosovë ka shumë.

Sot këtu u dëgjua edhe komenti se ligji nuk është shkelur. Ligji edhe mund të mos jetë shkelur, por se milionat po keqpërdoren është fakt. Unë po i përmendi një ose dy raste, sepse raste të tilla për t'i përmendur të gjitha, do të duhej të flitej me javë të tëra.

Tekstet shkollore të ciklit të ulët që paguhën nga buxheti i shteti para disa viteve kushtonin rreth dy milion euro. Të njëjtat tekste, këto vitet e fundit kushtojnë nga 7-8 milionë euro. Shembuj të tillë ku ligji nuk është shkelur, por është keqpërdorur buxheti ka shumë, deri te ai që një laps-kimik që mund të blihet kudo që të doni 20 cent, përmes tenderëve të Qeverisë, edhe të komunave, paguhet 15-fish e 20-fish më shtrenjtë, e prapë ligji nuk është shkelur, por këtu ka keqpërdorim të buxhetit.

Sot në këtë seancë ne si Kuvend do të duhej të konstatojmë se në Kosovë ka keqpërdorime, ka korrupsion, ka krim të organizuar dhe se po ashtu duhet të konstatojmë se institucionet e shteti nuk po i luftojnë këto dukuri tepër të dëmshme për vendin. Po ashtu duhet të konstatojmë se ndonjëherë dhe bile shpeshherë këto institucione edhe e ndihmojnë fshehjen e këtyre dukurive, e ka raste jo fort të rralla kur brenda këtyre institucioneve ka individë që janë pjesë e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Pasi t'i konstatojmë dukuritë e lartpërmendura që dje i konstatuan edhe ambasadorët e vendeve mike të Kosovës që ne i përmendim shpesh e i respektojmë kështu formalisht, po kur na e bëjnë me dije se ne nuk po veprojmë në të mirën e vendit tonë, atëherë disi mundohemi t'i amortizojmë deklaratat e tyre.

Ambasadorët dje kanë thënë, ky i Britanisë së Madhe se në Kosovë nuk po luftohet krimi dhe këto janë arsyet që Kosova edhe po ngec në zhvillim dhe ka mbetur e izoluar. Po ashtu është folur edhe për gylenistët që janë dëbuar nga vendi e që sipas komenteve të njerëzve tanë çdo gjë ka qenë në rregull me ligjet tona, po në të vërtetë një gjë e tillë nuk qëndron.

Ne duhet të konstatojmë që me këto sjellje të papërgjegjshme tonat, po e rrënojmë këtë shtet. Që po e izolojmë këtë shtet. Që për shkak të kësaj gjendjeje të rëndë brenda vendit po ofrohen zgjidhje shumë të dëmshme për të ardhmen e shtetit tonë dhe ata që po na përfaqësojnë të shantazhuar për shkak të keqpërdorimeve që i kanë bërë nuk janë të gjendje ta mbrojnë interesin e vendit, po bëhen argatë të projekteve të huaja.

Këto që u thanë më lartë po e nxitin edhe shpërnguljen e të rinjve tanë, që është një ndër dëmet më të mëdha që po i ndodhin këtij vendi.

Në këtë vend, buxhetin e shtetit po e zhvatën zyrtarë të të gjitha kategorive, sepse zyrtarët e lartë të këtij vendi janë zhatës të mëdhenj të buxhetit, keqpërdorues të mëdhenj dhe të korruptuar të mëdhenj, dhe bashkëpunëtorë të mëdhenj të krimit të organizuar.

Kjo që ndodh gjatë dy dekadave të fundit është shumë serioze. Është shumë e dëmshme dhe është vështirë të pengohet nga ata që gjenden e ka sjellë këtu ku është, por këtë gjendje duhet ta zgjidhin vetëm qytetarët e Kosovës që janë të interesuar të jetojnë në këtë vend dhe ta zhvillojnë vendin.

Me konstatime dhe me hedhjen e fajit nga njëra anë në anën tjetër, ne nuk ndikojmë pozitivisht vetëm sa e thellojmë krizën dhe e thellojmë gjendjen e rëndë në këtë vend. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

**FITORE PACOLLI:** Të nderuar qytetarë të Republikës,  
Më datën 5 mars, në dhomën e përfaqësuesve të Parlamentit Britanik është diskutuar për Kosovën. Në këtë diskutim, deputeti i Partisë Laburiste Gjon Grogon, në fjalimin e tij shprehet i kënaqur kur thotë se; ndihem i kënaqur se Presidenti i Kosovës ka ndryshuar qasjen sa i përket çështjes së korrigjimit të kufijve.

Por, na e zbulon një informatë dhe thotë se; shumë para Presidenti i Kosovës ka shpenzuar këtu në Londër dhe në vendet tjera për të lobuar për ndarjen e Kosovës.

Nga ndarjet për shpenzimet buxhetore, pra të paparashikueshme, Presidentit të Kosovës, kryeministri i cili flet kundër iniciativës së tij, i jep presidentit 100 mijë euro. Pra, për ta paguar kompaninë ‘Balord & Partners’.

Sipas Presidencës, kjo kompani do të mbështesë nismat e Kosovës të cilat kanë të bëjnë me ballafaqimin me të kaluarën. Të ndihmojë në krijimin e një dinamike të re në procesin e pajtimit.

Ne e dimë se cila është dinamika e re që e ka propozuar Presidenti i Kosovës. Pra, dinamika e re e pajtimit sipas tij është ndarja e territorit të Republikës së Kosovës. Ndërkaq, kryeministri në njërin anë shtiret sikur e kundërshton iniciativën e presidentit për shkëmbimin dhe korrigjimin e kufijve, ndërsa në anën tjetër i jep presidentit para që të llojë për ndarjen e Kosovës.

Kryeministri duhet të na tregojë se mbi çfarë pretendimi të presidentit u bind që t’ia ndajë paratë Hashim Thaçit që të llojë për ndarjen e Kosovës. Duhet te na e japë një përgjigje.

Arsyetimi i kryeministrit këtu për të gjitha shpenzimet ishte se janë në përputhje me ligjin dhe se... Atëherë, sipas tij, nëse çdo shpenzim i cili është në përputhje me ligjin është i arsyeshëm, atëherë në përputhje me ligjin kryeministri ka ndarë para për të lobuar për ndarjen e Kosovës.

Paratë e përcaktuara për shpenzime të paparashikueshme, kjo Qeveri i ka ndarë për një aktivitet tërësisht të paparashikueshëm të presidentit, e për një çështje për të cilën kryeministri shprehet çdo ditë se është kundër. Pra, kryeministri po e financon lobimin për ndarjen e Kosovës, ndërsa para qytetarëve po shprehet se kinse e kundërshton.

Pastaj, 300 mijë euro i ndahen të ashtuquajturit Delegacion Shtetëror. Një deputete pak më herët tha se po të ishte ajo, paratë do t'i shpenzonte në ndërtimin e çerdheve, por harroi se 300 mijë po i shpenzon shefi i saj dhe atë duke shkuar tinëz në Bruksel. Këto 300 mijë euro shefi i saj më mirë do të ishte që t'i shpenzonte në ndërtimin e një çerdheje në Prishtinë, dhe jo të sillej poshtë e lart nëpër Bruksel dhe të shpenzojë para kot nga taksat e qytetarëve.

Tutje, 120 mijë euro janë ndarë për takimin e datë 29 nëntor 2018. Pra, takim mes Kosovës dhe Shqipërisë. Një ditë takim janë paguar 120 mijë euro. Logjika thotë se për këtë takim do duhej paguar salla, dreka e darka dhe shpenzime të transportit, që maksimumi kishte arritur ndoshta 5 mijë. Të cilat prapë janë shumë. Por, të shpenzohen brenda një dite 120 mijë, unë nuk po arrijë ta kuptoj se çfarë kanë shpenzuar me këto para. Çfarë kanë blerë ose çfarë kanë ngrënë me këto para. 120 mijë euro për një takim njëditor, paramendojeni.

Pastaj, fondacionit Sfidat e Mijëvjeçarit i ndahen 200 mijë euro. Ky është një projekt pa rezultat. Pra, projekt që nuk ka vizion. Ky fondacion drejtor e ka Petrit Selimin, këshilltarin e presidentit. Dhe nëse e shohim deri më tani nuk ka sjellë ndonjë ndryshim. Pse i japim para kot këshilltarit të presidentit.

Për fund, kryeministri e tha që është praktikë në Kosovë. Nuk është diçka e re dhe se ai ka vazhduar me këtë praktikën qysh kanë vazhduar edhe qeveritë para tij, atëherë ky kryeministër duhet të shkojë, sepse ky kryeministër ka ardhur në pushtet për ta ndryshuar këtë situatë dhe jo të vazhdojë me praktikën të cilat kanë qenë të dëmshme dhe në të kaluarën.

Prandaj, në këtë mënyrë kjo na lë të kuptojmë se vendi duhet të shkojë zgjedhje sa më parë që është e mundur. Kjo Qeveri duhet të shkojë. Dhe vendi ka nevojë për Lëvizjen Vetëvendosje që t'i ndryshojë praktikën.

Neve na nevojitet një qeveri që nuk vazhdon me praktika të cilat kanë qenë më herët, sepse është e logjikshme kur ndryshohet një qeveri ndryshojnë edhe praktikën. Çdo qeveri duhet të sjellë praktika të reja dhe më të mira për vendin dhe jo të vazhdojë me praktika të dëmshme të cilat e shkatërrojnë vendin.

Prandaj, këto praktika të dëmshme mund t'i ndryshojë vetëm Lëvizja Vetëvendosje dhe për këtë arsyeje është e domosdoshme që kryeministri të japë dorëheqje. Pra, të dalë dhe të thotë se nuk ka arritur ta bëjë ndryshimin të cilin ka thënë se do ta bëjë. Nuk ka arritur t'i ndryshojë praktikatat e dëmshme të cilat i ka bërë presidenti dhe udhëheqës të tjerë të qeverisë dhe të ecim tutje. Pra, të vijë koha për një parti siç është Lëvizja Vetëvendosje që të ndryshohen këto praktika. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e zoti Selmanaj si ushtrues i kërkesës që të bëjë propozimet përfundimtare sa i përket debatit dhe pastaj po shohim se a kemi kuorum për të votuar. Zoti Selmanaj, fjala është për ju.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin në këtë debat, përkundër asaj që unë dua të shpreh zhgënjimin e thellë që askush prej këtyre njerëzve të cilët janë përgjegjës që t'i shpërlajnë paratë e shtetit nuk janë këtu. Domethënë nuk kanë interes fare për këtë punë.

Thënë të drejtën për zotin Hamza kam pak mirëkuptim sepse ai, ama nuk është duke e pyetur askush për këtë fare pune hiç. Në disa raste edhe kur kemi biseduar individualisht e ka pranuar që është dorëzuar pothuajse në aspektin sesi menaxhohet paraja publike në Kosovë.

Tashti, vetëm një përmbledhje të shkurtër. Unë i dëgjova me kujdes argumentet dhe sidomos deputetët e partive që vijnë nga radhët e partive politike në pushtet. Në fakt nuk kishte argumente. Duhet të jem shumë i sinqertë.

Aty kishte dy kontestime të tematikës; e para aspektin procedural, na thanë pse e keni sjellë në seancë dhe pse jo diku tjetër. Unë po ju them edhe njëherë, e kemi thirr kryeministrin në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe ai nuk ardhur.

Po ju them edhe diçka tjetër, tri herë i kemi thirrur tri ministri; ministrin e Bujqësisë, ministrin për Komunitete dhe Kthim, ministrin e Zhvillim Rajonal që të vijnë dhe të na tregojnë për mënyrën e shpenzimit të grandeve dhe subvencioneve, sepse kemi informata të mjaftueshme që aty po abuzohet. Nuk vijnë kurrë. As përgjigje nuk po na japin. Ka tre-katër muaj që kemi bërë kërkesë drejtuar këtyre ministrive, nuk vijnë.

Dhe ne, kur ju po na e ngushtoni hapësirën që të bëjmë politikë institucionale, s'kemi qare pa e zgjedhur edhe instrumentin e seancave të jashtëzakonshëm. Na i lini instrumentet tjera, po nuk na i latë, atëherë ne kemi punë me njerëz që na shikojnë, sepse me këta s'kemi çka flasim, s'kemi me kë flasim. Besa edhe juve jo, se keni ardhur pak, pro duhet t'i adresojmë këto çështje.

E dyta, çështja e datës. Po si nuk po ju vjen turp për këtë çështjen e datës. Singërisht, këtu definitivisht kemi humbur çdo fill njerëzie.

Më 5 mars, ku ka filluar Epopeja e UÇK-së s'keni dashur të flitni për vjedhjet në Kosovë, vjedhjen e parasë publike në Kosovë. Po, kur është vrarë Adem Jashari me krejt familjen e tij, ju keni ardhur këtu dhe e keni rrëzuar kërkesën tonë që të shtyhet ajo seancë dhe keni diskutuar për dialogun me Serbinë. Kjo jo hipokrizi, po jeni duke ia lëkundur eshtrat edhe Adem Jasharit dhe të rënëve në Kosovë. Po mos veproni kështu more.

Duhet pak njerëzi të kemi në këtë punë, sepse kemi dalë përtej të gjithë asaj që mund të kuptohet normale në këtë vend.

Çështja tjetër ka të bëjë...Ne diskutuam për shumë tematika dhe disa nuk u përmenden. Unë po ua përmendi vetëm edhe një rast i cili tregon se deri ku shkon mënyra sesi ndahen këto para nga shpenzimet e paparashikuara.

Për Vitin e Ri, vitin e kaluar, janë ndarë para për dhurata për fëmijët në Leposaviq edhe në Zubin-Potok nga 25 mijë euro. Në Leposaviq dhe në Zubin-Potok, 25 mijë euro. Unë nuk jam kundër, por pse jo edhe për fëmijët e Prekazit? Pse jo edhe për fëmijët e Abrisë? Pse jo edhe për fëmijët e Gllogjanit?

Domethënë diçka kemi gabuar rëndë këtu ose jemi në shërbim të tjetër kujt. Duhet ndoshta të plotësohet ndonjë apetit i Radojçiqit ose dikujt tjetër që të përkëdhelen edhe fëmijët e tyre, po kështu nuk shkon. Kjo del përtej logjikës shtetërore. Përtej logjikës institucionale në Kosovë.

Një numër i madh e thanë që në fakt është arritur qëllimi i kësaj seance, sepse tash nuk janë 500 mijë euro që po shpenzohen. Pra, ra në 170 mijë. Dhe ky është kryelajm. Domethënë prej 500 mijë eurove kanë rënë në 170 mijë. Por, unë e lus kryeministrin që në të njëjtën formë të veprojë edhe me vitin e kaluar.

Për 885 mijë për pavarësinë dhe për 500 mijë me rastin e shënimit të përvjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriot - Skënderbeut.

Jam i sigurt se nëse i hyjmë një adutimi të tillë do të sillni në 200 mijë edhe me ato. Diku rreth 600 mijë euro do t'ia shpëtoni këtij vendi. Pra, i bie se nëse nuk flasim dhe nuk u zëmë, atëherë vazhdoni me vjedhë, por nëse flasim dhe ju zëmë, ndaleni pak.

Logjika kështu po e nxjerr përfundimin.

Ajo që është e rëndësishme, ne mund të flasim tash me orë të tëra, me ditë të tëra, po faktet mbesin. Aty do të mbesin të gjitha këto vendime që janë marrë deri sot dhe normalisht derisa Lekë Lumezit edhe Bahri Hysenit një ditë do t'ju thërrasë ndërgjegjja e pastër dhe thonë se, ngadalë se po u dashka të merrmi me këto punë, ose vjen një klasë tjetër e të menduarit dhe të vepruarit politik institucional në Kosovë, dhe vendos të merret seriozisht me këto tema.

Unë po i lexoj dy pika të rezolutës edhe njëherë dhe normalisht që nuk ju ftoj sot për votim, sepse s'kemi as kuorum, por e lëmë për herën tjetër. Por, nëse eventualisht ka përsëri kërkesa për t'u plotësuar kjo, e plotësojmë.

Rezoluta i ka dy pika:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ta ndalë praktikën e ndarjes së mjeteve financiare pa kriter dhe pa respektuar dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësit dhe
2. Në një afat prej një jave, Qeveria, përkatësisht Zyra e Kryeministrit të sjellë në Kuvend një raport për procedurat e zhvilluar për të realizuar aktivitet për mënyrën e shpenzimit të mjeteve me fokus të tri ngjarjeve: Shënimin e përvjetorëve 2018 dhe 2019 që lidhen me përvjetorin e pavarësisë dhe shënimin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Përsëri po e them se jemi të hapur nëse eventualisht gjatë kësaj periudhe deri sa ta vendosim në seancën tjetër, ta plotësojmë me ndonjë propozim eventual. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Driton, situatën e kemi të tillë që s'kemi kuorumin e duhur për votim. Unë e përfundoj debatin lidhur me këtë seancë. Nesër kemi seancë të re, në qoftë se ka kuorum e votojmë nesër rezolutën e propozuar. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*